



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 71

Tiranë – E hënë, 11 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 24.4.2015	3147
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 24.4.2015	3154
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 27.4.2015	3175



VENDIM
Nr. 22, datë 24.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 04.11.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare me dyer të hapura, çështjen me nr. 45/13 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Oerd Bylykbashi, Ivi Kaso dhe Gazmend Bardhi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Alban Brati, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga Artur Metani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 4 të ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 86, 94, 124, 131/a dhe 134/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj; përfaqësuesit e kërkuarit, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Në vitin 2003 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (*ligji nr. 9049/2003*), i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta (neni 1).

2. Sipas këtij ligji, organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm, i cili “...*zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit, ndërmjet dy kandidaturave, për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje*” (neni 11/2). Inspektori i Përgjithshëm drejton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, person juridik publik, i cili, nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm, administron deklarimin e pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi sipas përcaktimeve të bëra në ligji (neni 16). Me miratimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i cili ka për qëllim garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta (neni 1), Inspektorati i Lartë emërtohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) dhe është autoriteti qendror përgjegjës edhe për zbatimin e këtij ligji (neni 41).

3. Me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014 (*ligji nr. 45/2014*), Kuvendi miratoi disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9049/2003. Mes të tjerash, me nenin 4 të ligjit nr. 45/2014 u bënë disa ndryshime në nenin 11 të ligjit nr. 9049/2003, i cili ka tani këtë përmbajtje:

“1. *Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm.*

2. *Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet me shumicën e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.*



3. Kuvendi i Shqipërisë, jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të mandatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, publikon shpalljen për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm.

4. Në rastet e mbarimit të mandatit, sipas nenit 14 të këtij ligji, shpallja për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm bëhet kryesisht nga Kuvendi, brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës.

5. Çdo shtetas, i cili plotëson kushtet e nenit 12 të këtij ligji, mund të paraqesë në Kuvend kandidaturën për Inspektor të Përgjithshëm. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që provon përmbushjen e kushteve ligjore dhe kritereve objektive.

6. Lista e kandidatëve i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kritereve dhe kushteve përkatëse. Komisioni i shqyrton kandidaturat në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Pas verifikimit të kushteve dhe kritereve zbatohet procedura si më poshtë:

a) komisioni përzgjedh, për t'u paraqitur për votim Kuvendit, tre kandidatët që gëzojnë mbështetjen më të madhe të anëtarëve të komisionit, por jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. Çdo anëtar i komisionit mund të mbështesë deri në katër kandidatët;

b) nëse shumicën e cilësuar, sipas shkronjës "a", nuk e gëzojnë së paku tre kandidatët, komisioni identifikon tre kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit, pas zbatimit të shkronjës "a";

c) kur gjatë zbatimit të shkronjave "a" dhe "b" dy apo më shumë kandidatët gëzojnë të njëjtën mbështetje, përzgjedhja e tyre bëhet me short.

Kandidatët e përzgjedhur, sipas procedurës së mësipërme, i kalojnë Kuvendit për votim.

7. Inspektori i Përgjithshëm bën deklarinimin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij dhe çdo vit, sipas nenit 4 të këtij ligji, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

8. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kështu para zgjedhjes së tij ose në një vend të barasvlershëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Inspektorit të Përgjithshëm."

II

4. Kërkuesi, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën

të nenit 4 të ligjit nr. 45/2014 dhe parashtron këto shkaqe:

4.1 Për legjitimitimin e kërkesit

4.1.1 Kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, pasi plotëson kriterin numerik të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja "c", i Kushtetutës.

4.1.2 Kërkuesi plotëson edhe kriterin tjetër, që ka të bëjë me pasjen e qëllimit dhe të nxitjes konkrete për të kërkuar kontrollin abstrakt të normës. Kushtetuta, në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, ndër të tjera, e ngarkon Kuvendin me funksionin e kontrollit parlamentar për çështjet që përmbajnë në vetvete një interes publik. Një nga format e këtij kontrolli është edhe mundësia që i njihet pakicës parlamentare për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në rrugën e një kontrolli abstrakt kur vlerësohet se një akt normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

4.2 Për themelin e kërkesës

4.2.1 Për nga kompetencat që ushtron, ILDKPKI-ja mund të vlerësohet si një "prokurori për çështjet financiare", për pasojë garantimi i pavarësisë së këtij institucioni është mënyra e vetme për të siguruar luftë reale ndaj korrupsionit në radhët e funksionarëve të lartë publikë. Për këtë qëllim, që nga krijimi i tij, duke vlerësuar pozicionin kushtetues të Presidentit të Republikës së Shqipërisë (Presidenti) dhe Kuvendit, ligji nr. 9049/2003 parashikonte një procedurë plurale të përzgjedhjes së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

4.2.2 Neni 92 i Kushtetutës parashikon kompetencat e Presidentit, por ato nuk janë kurrsesi shteruese, çka përforcohet edhe nga formulimi gjuhësor i kësaj dispozite. Ndërkohë, neni 94 parashikon se Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht në Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të. Kjo zgjedhje nuk është e rastësishme, por lidhet me pamundësinë që ka kushtetutëbërësi për të parashikuar në mënyrë shteruese këto kompetenca, si dhe për t'u dhënë zgjidhje situatave juridike të paqena në momentin e hartimit të Kushtetutës. ILDKPKI-ja është krijuar për herë të parë në vitin 2003, kurse Kushtetuta është miratuar në vitin 1998, si rrjedhim në atë moment ka qenë e pamundur të



mbahej në konsideratë ekzistenca në të ardhmen e këtij institucioni të rëndësishëm.

4.2.3 Zgjedhja e bërë nga ligji nr. 9049/2003 nuk është e rastësishme, pasi kjo formulë emërimi lidhet drejtpërdrejt me rolin që ka Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së dhe pavarësinë nga politika/mazhoranca që ai duhet të gëzojë. Investimi i dy organeve në zgjedhjen e tij është garanci e ofruar nga ligji për ruajtjen e pavarësisë së këtij institucioni.

4.2.4 Neni 4 i ligjit nr. 45/2014 bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, si dhe me nenet 86 e 94 të Kushtetutës. Është pikërisht neni 94 i Kushtetutës i cili shpreh qartë frymën dhe qëllimin e kushtetutëbërësit për t'i mundësuar ligjvënësit një lloj fleksibiliteti në përcaktimin e kompetencave të tjera të Presidentit, për çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e marrëdhënieve ndërmjet organeve shtetërore apo institucioneve të krijuara me ligje të veçanta, siç është rasti i ILDKPKI-së. Ligji nr. 9049/2003 është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ndryshimi i tij, si i çdo ligji tjetër, duhet të arsyetohet dhe justifikohet.

4.2.5 Neni 4 i ligjit nr. 45/2014 cenon parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Në përputhje këtë parim, ligji parashikonte zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, si një titullar i një institucioni të pavarur, sipas një procesi që kishte në themel të tij kooperimin institucional të Presidentit dhe Kuvendit. Është e qartë se përzgjedhja e bërë nga Presidenti i nënshtrohej kontrollit të Kuvendit, i cili vlerësonte jo vetëm respektimin e kriterëve përzgjedhëse të përcaktuara më parë prej tij, por edhe meritën e kandidatëve të propozuar. Kjo formulë përzgjedhëse, e ndërveprimit midis organeve brenda kuadrit kushtetues, ishte vlerësuar si instrument mbrojtës ndaj monopolizimit të pushtetit shtetëror vetëm në duart e një organi dhe që mund të ketë një efekt shkatërrues mbi qeverisjen kushtetuese.

5. **Subjekti i interesuar, Kuvendi,** ka prapësuar përpara Gjykatës sa vijon:

5.1 Heqja me ligj e kompetencës ligjore të Presidentit, për t'i propozuar Kuvendit dy kandidatura për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, dhe zgjedhja e tij

nga Kuvendi, nëpërmjet një procedure konkurruese, është bërë prej Kuvendit jo vetëm në ushtrim të funksionit të tij legjislativ, të parashikuar nga nenet 7 dhe 81-85 të Kushtetutës, por edhe në respektim të plotë të nenit 94 të Kushtetutës.

5.2 Kompetenca ligjore e Presidentit për propozimin e kandidaturave për zgjedhjen e kreut të ILDKPKI-së, e parashikuar në ligjin nr. 9049/2003, nuk është një kompetencë që buron nga Kushtetuta apo që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një kompetencë kushtetuese të tijen. Për këtë arsye, heqja e kësaj kompetence nuk cenon statusin e Presidentit si Kryetar i Shtetit, i cili, edhe pse në mënyrë deklarative është sanksionuar në nenin 86 të Kushtetutës, del dhe përcaktohet nga tërësia e kompetencave që Kushtetuta i ka njohur dhe i ka dhënë vetë Presidentit në ushtrim të këtij statusi.

5.3 Neni 7 i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, ka për qëllim të deklarojë këtë parim, ndërsa garantimi i tij arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që sigurojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm ndërmjet pushteteve. Kjo dispozitë kushtetuese kufizohet vetëm në sanksionimin e këtij parimi ndërmjet tri pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Duke qenë se Presidenti nuk përfshihet dhe nuk bën pjesë në asnjërin prej tyre, pretendimi për cenimin e këtij parimi nuk mund të shtrohet për diskutim.

5.4 Asnjë rregullim kushtetues nuk parashikon shprehimisht si kompetencë të Presidentit të drejtën e tij për t'i propozuar Kuvendit dy kandidatura për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Për rrjedhojë, heqja e kësaj kompetence ligjore nuk ka mënjeluar ose tejkaluar përmbajtjen e ndonjë dispozite konkrete kushtetuese, e cila duhet detyrimisht të zbatohet drejtpërdrejt.

5.5 Nenet 7 dhe 86 të Kushtetutës janë dispozita me karakter deklarativ dhe ato nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt të vetme, të shkëputura dhe jashtë kontekstit të dispozitave të tjera kushtetuese, të cilat përcaktojnë si tërësinë e kompetencave që Kushtetuta i ka njohur dhe dhënë Presidentit në ushtrim të statusit të tij si Kryetar i Shtetit, ashtu edhe mekanizmat dhe zgjedhjet kushtetuese që e garantojnë zbatimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.



6. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka prapësuar përpara Gjykatës sa vijon:

6.1 Përmbajtja e nenit 94 të Kushtetutës është mjaft e qartë në lidhje me natyrën shtetërore të kompetencave të Presidentit brenda funksioneve që ai ushtron në një republikë parlamentare.

6.2 Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese e kanë bërë tashmë dallimin ndërmjet institucioneve kushtetuese, nga njëra anë, dhe institucioneve me rëndësi kushtetuese apo të parashikuara nga Kushtetuta, nga ana tjetër. ILDKPKI-ja nuk është një organ kushtetues apo i krijuar nga Kushtetuta, por një institucion ligjor i krijuar në përputhje me parimet kushtetuese.

6.3 Ligjvënësi, në interpretim të nenit 94 të Kushtetutës, duke ndryshuar procedurën e përzgjedhjes së Inspektorit të ILDKPKI-së, ka vlerësuar se kjo dispozitë kushtetuese, e shprehur në terma mohuese dhe përjashtimore, nuk ka pasur dhe nuk ka për qëllim që ligje të veçanta t'i japin dhe t'i lejojnë Presidentit ushtrimin e kompetencave të tjera, tej atyre që i njihen me Kushtetutë.

6.4 Neni 94 i Kushtetutës i vendos ligjvënësit kufizimin kushtetues që, në respekt të pozicionit që ka ky institucion (Presidenti), të mos bëhet objekt i kompetencave shtetërore që dalin jashtë natyrës që Kushtetuta i ka njohur atij. Çdo kompetencë e shtuar, jashtë atyre që Presidenti ka dhe i njihen shprehimisht në Kushtetutë, do të përbënte denatyrim të rolit të tij.

6.5 Në miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 9049/2003, Kuvendi ka vlerësuar funksionin kryesor që ka ILDKPKI-ja. Reformimi ka pasur si qëllim kryesor rritjen e garancive ligjore që Inspektori i Përgjithshëm duhet të gëzojë gjatë kryerjes së detyrës, si dhe forcimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore profesionale për zgjedhjen e tij.

6.6 Neni 4 i ligjit nr. 45/2014 referon në pikën 12 të këtij ligji, i cili parashikon kushte dhe kriteret të forta profesionale për të qenë kandidat e më pas për t'u zgjedhur. Shumica e parashikuar në ligj për zgjedhjen dhe shkarkimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së e ka vendosur këtë zyrtar të lartë të administratës shtetërore në një pozicion të veçantë, krahasuar edhe me procedurën e përdorur për zyrtarë të tjerë, funksionet e të cilëve gjejnë rregullim të posaçëm në Kushtetutë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

7. Gjykata vëren se Kushtetuta, në nenin 134, pika 1 të saj, ka përcaktuar rrethën e subjekteve të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në pikën 2 të po këtij neni, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim a contrario, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” të po kësaj dispozite, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) të subjektit kushtetues një e pesta e deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo, në mënyrë të vazhdueshme, ka vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134/1, shkronja “c”, të Kushtetutës, bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 18, datë 29.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesi, një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit, përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar dhe, si i tillë, legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

*B. Për thelbin e pretendimeve*

10. Kërkuesi pretendon se dispozita e kundërshtuar bie ndesh me parimet e sanksionuara në nenin 4 dhe nenin 7 të Kushtetutës. Sipas tij, neni 94 i Kushtetutës shpreh frymën dhe qëllimin e kushtetutëbërësve për t'i mundësuar ligjvënësit një lloj fleksibiliteti në përcaktimin e kompetencave të tjera të Presidentit për çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e marrëdhënieve ndërmjet organeve shtetërore apo institucioneve të krijuara me ligje të veçanta, siç është rasti i ILDKPKI-së. Po ashtu, në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancës midis pushteteve, ligji parashikonte zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, si një titullar i një institucioni të pavarur, sipas një procesi plural, që kishte në themel të tij kooperimin institucional të Presidentit dhe Kuvendit të Shqipërisë, formulë kjo që garantonte shmangien e përqendrimit të pushtetit vetëm në duart e mazhorancës.

11. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendi, kompetenca ligjore e Presidentit për propozimin e kandidaturave për zgjedhjen e kreut të ILDKPKI-së, nuk është një kompetencë që buron nga Kushtetuta apo që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një kompetencë kushtetuese të tijën.

12. Sipas subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, neni 94 i Kushtetutës nuk ka pasur dhe nuk ka për qëllim që ligje të veçanta t'i japin dhe t'i lejojnë Presidentit ushtrimin e kompetencave të tjera, tej atyre që i njihen me Kushtetutë. Kjo dispozitë kushtetuese i vendos ligjvënësit kufizimin kushtetues që, në respekt të pozicionit që ka ky institucion (Presidenti), të mos bëhet objekti i kompetencave shtesë që dalin jashtë natyrës që Kushtetuta i ka njohur atij.

13. Gjykata ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuara prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat

kushtetuese dhe ligjore (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Si një nga elementet e shtetit të së drejtës, parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve synon, kryesisht, të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit (*shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të gjykuar lidhur me këtë parim, duhet të nisemi, nga njëra anë, nga natyra e organit (kushtetues ose jo) dhe, nga ana tjetër, nga natyra e kompetencave që vihen në diskutim (kushtetuese ose jo).

16. Neni 86 i Kushtetutës parashikon se “Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”. Në nenin 92 të Kushtetutës janë parashikuar kompetencat që ushtron Presidenti, kurse në nenin 94 parashikohet se “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”. Ideja e hartuesve të Kushtetutës ka qenë që për shumicën e kompetencave kushtetuese të



Presidentit do të duhen ligjet përkatëse për t'i zbrërthyer ato dhe se çdo kompetencë kushtetuese do të shoqërohet ose mbështetet në një ligj që do të miratohet në të ardhmen. Hartuesit e Kushtetutës nuk e kanë përjashtuar mundësinë që Presidentit t'i jepen kompetenca në ligje të veçanta, por i rëndësishëm për ta ka qenë fakti që Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca pa ligj (*shih Debatë Kushtetues, vëllimi 1, fq. 324-325*).

17. Kompetencat e Presidentit, bazuar në teknikën legislative të ndjekur nga hartuesit e Kushtetutës, nuk janë të renditura njëra pas tjetrës, por janë të shpërndara nëpër krerë të ndryshëm të Kushtetutës (*shih Debatë Kushtetues, vëllimi 1, Tiranë 2006, fq. 320-321*). Hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e tij si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive (*shih Debatë Kushtetues, vëllimi 2, Tiranë 2006, fq. 425; vëllimi 1, fq. 319-320*). Në aspektin e përgjithshëm, Gjykata, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se kompetencat e tij janë përcaktuara në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës (*shih vendimin nr. 10, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar se rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithëse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai, detyrimisht, do të zbatohet drejtpërdrejt (*shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se për

funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimin nr. 10, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në bazë të nenit 94 të Kushtetutës, ligji mund të përcaktojë kompetenca të tjera të Presidentit, megjithatë natyra e tyre nuk duhet të jetë e tillë që të bjerë ndesh me këtë funksion, të shkaktojë mospërputhje ose t'u kundërvihet kompetencave të tij kushtetuese. Dispozitat kushtetuese që rregullojnë kompetencat e Presidentit përcaktojnë thelbin e këtij institucioni dhe nxjerrin në pah vendin e tij në sistemin e pushteteve të shtetit dhe marrëdhëniet e tij me institucionet e tjera. Gjykata rithekson se përcaktimi i kompetencave në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë kompetencat e një institucioni tjetër apo t'i anashkalojë ato. Për pasojë jo vetëm kompetencat kushtetuese të Presidentit nuk mund të ndryshohen ose kufizohen me ligj, por edhe kompetencat shtesë që mund t'i jepen me një ligj të caktuar, nuk mund të shkaktojnë mospërputhje dhe as të bien në kundërshtim me kompetencat e tij kushtetuese dhe statusin e tij si kreu i shtetit.

20. Gjykata vëren se Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë të shprehur një kompetencë të përgjithshme të Presidentit për emërimin apo shkarkimin e zyrtarëve apo funksionarëve të lartë të shtetit, siç e gjejmë në disa kushtetuta të tjera¹. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kompetenca ligjore e njohur Presidentit të Republikës për emërimin e kreut të ILDKPKI-së nuk është zbrërthim i kompetencave të tij kushtetuese, për pasojë heqja e kësaj kompetence po me ligj nuk përbën cenim të parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve.

21. Gjykata vëren, gjithashtu, se në thell

¹ Neni 87 i Kushtetutës së Italisë parashikon se Presidenti “emëron, në rastet e përcaktuara nga ligji, funksionarët e shtetit”. Neni 84/10 i Kushtetutës së Lituaniës parashikon se Presidenti “emëron dhe shkarkon, në përputhje me procedurën e përcaktuar, zyrtarët e parashikuar me ligj”. Neni 94/c i Kushtetutës së Rumanisë parashikon se Presidenti ka kompetencë “emërimin në funksione publike sipas kushteve të parashikuara me ligj”. Neni 107 i Kushtetutës së Sllovenisë parashikon se Presidenti ka kompetencë “të emërojë zyrtarët dhe funksionarët e shtetit në përputhje me ligjin”.



pretendimet e kërkuesit i referohen statusit dhe pozicionit që gëzon ILDKPKI-ja si një organ i pavarur. Sipas tij, për garantimin e pavarësisë së këtij institucioni, që është mënyra e vetme për të siguruar luftë reale ndaj korrupsionit në radhët e funksionarëve të lartë publikë, ishte parashikuar zgjedhja e kreut të tij sipas një procesi plural, që kishte në themel të tij kooperimin institucional të Presidentit dhe Kuvendit. Kërkuesi pretendon se zgjedhja e bërë nga ligji nr. 9049/2003 nuk është e rastësishme, pasi kjo formulë emërimi lidhet drejtpërdrejt me rolin që ka Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së dhe pavarësinë nga politika/mazhoranca që ai duhet të gëzojë. Investimi i dy organeve në zgjedhjen e tij është garanci e ofruar nga ligji për ruajtjen e pavarësisë së këtij institucioni.

22. Kushtetuta ka parashikuar një mbrojtje të veçantë për disa organe kushtetuese, duke e parë këtë të nënshtrimi i tyre vetëm ndaj saj e ligjeve, të miratimi i ligjeve për organizimin e funksionimit e këtyre institucioneve me një shumicë të cilësuar prej 3/5 e deputetëve, të garantimi i pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare etj. Përveç sa më sipër, Kushtetuta ka parashikuar krijimin e disa organeve qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilëve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Këto organe, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me dispozita të veçanta të Kushtetutës. Të tilla janë: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, apo Prokurori i Përgjithshëm. Duke theksuar pavarësinë e këtyre organeve, është bërë kujdes që Kushtetuta të mos i lërë ata jashtë çdo lloj kontrolli. Ajo vendos raporte të caktuara mes vetë atyre, si dhe mes tyre dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror, veçanërisht me Kuvendin. Këto raporte krijojnë mundësi për ushtrim kontrolli reciprok dhe për balancim të mjaftueshëm të pushtetit, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionin kushtetues të secilit prej tyre. Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së këtyre organeve apo institucioneve kushtetuese është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe

sidomos shkarkimin e drejtuesve apo anëtarëve të tyre. Parashikimi për këtë qëllim i mekanizmave të tillë, si shumica e cilësuar në Kuvend, vendimmarrja e Presidentit të Republikës ose e Gjykatës Kushtetuese, vlerësohet si masë e rëndësishme dhe efektive në funksion të ruajtjes dhe forcimit të kësaj pavarësie (*shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vlerësimin e Gjykatës, zbatimi i një sistemi të kontrollit dhe deklarimit të pasurive është një element i rëndësishëm në luftën antikorrupsion. Një nga modelet e rregullimeve institucionale për mbledhjen dhe përpunimin e deklaratave të zyrtarëve publikë, është ai i zbatuar në vendin tonë, që parashikon krijimin e një institucioni të specializuar kontrolli. Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit të vitit 2003 (e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2006), janë dhënë disa rekomandime për agjencitë/institucionet mbikëqyrëse. Sipas nenit 6/2 të Konventës, shtetet palë duhet t'u sigurojnë institucioneve të tilla pavarësinë e nevojshme, në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë efektive dhe të lirë nga çdo ndikim i papërshtatshëm. Ndër elementet që garantojnë pavarësinë e këtyre institucioneve përfshihen qartësia e mandatit, e juridiksionit dhe kompetencave, rregullimi i veçantë institucional për të kufizuar diskrecionin dhe për të rritur integritetin e meritën në emërimin dhe pezullimin/shkarkimin e kreut të institucionit, si dhe të stafit të tij, garanci të financimit të qëndrueshëm etj.

24. ILDKPKI-ja nuk është një organ kushtetues apo një organ i parashikuar nga Kushtetuta dhe as funksioni i Inspektorit të Lartë të këtij institucioni nuk është një funksion kushtetues. Po ashtu, pavarësia e këtij organi nuk është garantuar kushtetutshmërisht. Për më tepër, nuk mund të konkludohet se ILDKPKI-ja është një organ i veshur me kompetenca që u përkasin organeve të ndjekjes penale, siç pretendon kërkuesi, të cilat do të kërkonin garanci shtesë të pavarësisë së tij. Bazuar në sa më sipër, zgjedhja në lidhje me mjetin e përdorur për paraqitjen e kandidaturave, kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati, kushtet ligjore më të përshtatshme për funksionin e kreut të ILDKPKI-së apo mënyrën e përzgjedhjes dhe emërimit të këtij funksionari, përbën një çështje që përfshihet në hapësirën e vlerësimit të ligjvënës. Gjykata rithekson se në zbatim të



funksionit të saj, ajo nuk mund të kontrollojë ose të orientojë paraprakisht vullnetin e ligjvënësit që të veprojë ose jo në një kohë ose mënyrë të caktuar. Në këtë vijë arsytimi, nuk mund të përbëjë çështje të juridiksionit kushtetues vlerësimi i arsyeve që mund të kenë ndikuar te ligjvënësi për trajtim të posaçëm të një çështjeje të caktuar. Është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të kontrollojë nëse rregullimi me ligj i kësaj çështjeje është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj (*shih vendimin nr. 30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vlerëson të theksojë se pavarësia ligjore e institucioneve që mbikëqyrin procesin e mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave në kuadër të sistemit të deklarimit të pasurive, mund të garantohet me anë të mjeteve të ndryshme ligjore. Në rastin konkret, me ndryshimet që neni 4 i ligjit nr. 45/2014 ka sjellë në nenin 11 të ligjit nr. 9049/2003, është parashikuar një procedurë paraprake për përzgjedhjen e kandidatave, që përfshin publikimin e shpalljes për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të mandatit (pika 3), verifikimin e kandidatave nga komisioni që mbulon çështjet ligjore dhe procedurën që ndiqet pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, si edhe shumicën e nevojshme për përzgjedhjen e kandidatëve që do i kalojnë Kuvendit për votim (pika 6). Për pasojë, përzgjedhja e kreut të ILDKPKI-së nëpërmjet një procesi të hapur publik dhe transparent, në vlerësimin e Gjykatës përbën një mjet ligjor që garanton pavarësinë e këtij institucioni.

26. Në përfundim, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara dhe kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 23, datë 24.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datat 13.11.-2014 dhe 4.12.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me nr. 51/19 Akti, që i përket:

KËRKUES: Një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike), përfaqësuar nga zoti Oerd Bylykbashi, zoti Ivi Kaso dhe zoti Gazment Bardhi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Armando Subashi dhe zoti Alban Brati, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga zoti Artur Metani, me autorizim.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar në gjykim nga zoti Tritan Hamitaj dhe zonja Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shpallja si i papajtuësëm me Kushtetutën, e ligjit nr.101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.

2. Pezullimi i ligjit nr. 101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë



17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 131, shkronja “a”, 134/1, shkronja “P”, 138 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, që kërkoji pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që kërkoji pranimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me propozimin e një grupi deputetësh në datën 24.07.2014 Kuvendi i Shqipërisë (më poshtë: Kuvendi) miratoi disa ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar. Ky ligj ka gjithsej 15 nene, të cilat ndryshojnë disa dispozita të ligjit bazë në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë: KLD-ja). Konkretisht, ndryshimet prekin çështje të tilla, si: papajtueshmëria e anëtarit të KLD-së me funksione/detyra të tjera, ndalimi i promovimit të anëtarëve të KLD-së gjatë kohës që mbajnë këtë funksion, mënyra e deklarimit të përfundimit të mandatit të anëtarit të KLD-së, rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD, mënyra e zgjedhjes së zëvendëskryetarit të KLD-së, pezullimi i gjyqtarit nga detyra me vendim të KLD-së në rastet kur ai merret i pandehur si dhe procedurën e emërimit të kryetarëve të gjykatave kur krijohen vakanca.

II

2. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kundërshtuar ligjin si antikushtetues për këto arsye:

2.1 Cenohen nenet 81/2 dhe 83/3 të Kushtetutës. Kushtetuta e ndalon zbatimin e procedurës së përsheptuar për ligje që kërkojnë shumicë të cilësuar. Ligji objekt kërkesë është ligj i përforcuar dhe si i tillë nuk mund të miratohej

me procedurë të përsheptuar. Projektligji nuk është përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit, duke mosrespektuar afatet për marrjen e dëgjimit dhe njoftimin e projektligjit deputetëve të Kuvendit. Gjithashtu, gjatë miratimit të ligjit nuk janë respektuar nenet 69 - 70 të rregullores së Kuvendit, përse i takon përfshirjes në kalendarin e punimeve dhe shqyrtimit të projektligjit në komisionet përgjegjëse.

2.2 Cenohet pavarësia e KLD-së si organ kushtetues, pasi ligji ia heq kompetencën e verifikimit të zgjedhshmërisë së anëtarëve të KLD-së. Heqja e kësaj kompetence prek në thelb parimin e ndarjes së pushteteve.

2.3 Dobësohet vetëqeverisja e gjyqësorit duke mosspecifikuar rastet e shkeljes së rëndë të ligjit si shkak për shkarkimin e anëtarit të KLD-së. Kjo gjë lë vend për abuzim duke mosgarantuar pavarësinë e KLD-së. Rastet e shkarkimit duhet të jenë të detajuara dhe shteruese, me qëllim ruajtjen e paprekshmërisë së këtij organi kushtetues.

2.4 Cenohet hierarkia e akteve normative, pasi ligji ka dalë tej kufijve të lejuar nga Kushtetuta. Zgjedhja e zëvendëskryetarit vetëm midis anëtarëve të KLD-së që zgjidhen nga Kuvendi është interpretim i ngushtë i dispozitës kushtetuese 147/3 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë bie ndesh me të. Kushtetuta ka parashikuar vetëm që zëvendëskryetari i KLD-së të zgjidhet nga radhët e anëtarëve, pa bërë dallime midis mënyrës së zgjedhjes së tyre, pra nëse zgjidhen nga Kuvendi apo Konferenca Gjyqësore Kombëtare (më poshtë: KGJK). Në këtë mënyrë ligji ngushton përmbajtjen e dispozitës kushtetuese, gjë e cila bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë.

2.5 Cenohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe sigurisë juridike për gjyqtarin, i cili pezullohet automatikisht nga detyra nëse merret i pandehur. Ky parashikim nuk jep garanci për gjyqtarin nëse deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë.

2.6 Kërkuesi kërkoji, gjithashtu, edhe pezullimin e zbatimit të ligjit deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga kjo Gjykatë, pasi, sipas tij, pasojat që vijnë nga zbatimi i tij janë të rënda dhe të pariparueshme.

3. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi, ka parapsëuar si vijon:



3.1 Pretendimi se ligji është miratuar me procedurë të përsheptuar, nuk qëndron. Projektligji është futur në programin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4-31 korrik 2014, i cili është miratuar edhe me konsensusin e opozitës. Bazuar në rregulloren e Kuvendit, programi i punimeve është akti i vetëm nëpërmjet të cilit një çështje përfshihet për t'u shqyrtuar në Kuvend. Miratimi i këtij akti është i mjaftueshëm që të lindë detyrimi i komisioneve të posaçme për të shqyrtuar projektligjin. Megjithatë, edhe pas miratimit të programit të punimeve, projektligji nuk është futur në rendin e ditës për shqyrtim nga komisioni pa kaluar afati dyjavor nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Pra, procedura e miratimit të ligjit ka qenë e rregullt. Vetëm fakti i mospërfshirjes së projektligjit në kalendarin e punimeve nuk e bën atë të parregullt, pasi afatet për qëllimet e njohjes dhe marrjes dijeni janë respektuar.

3.2 Pretendimi për cenim të pavarësisë së KLD-së për shkak të mosverifikimit të zgjedhshmërisë së anëtarëve të KLD-së nuk është i bazuar. Ligji bën një ndarje midis kompetencave të organit ligjvënës dhe KLD-së duke përcaktuar në përputhje me funksionet e tyre edhe rolin konkret që ato kanë në verifikimin e zgjedhshmërisë dhe rastet e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KLD-së.

3.3 Nuk cenohet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve nga dispozitat që parashikojnë rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së. Ky organ kushtetues, megjithëse është i pavarur, nuk mund të jetë i përjashtuar nga kontrolli i ndërsjellë i organeve të pushteteve të tjera, siç parashikohet edhe nga neni 7 i Kushtetutës, i cili përveç ndarjes së pushteteve garanton edhe balancimin e tyre. Asnjë funksionar nuk mund të jetë i pakontrollueshëm dhe i përjashtuar nga përgjegjësia, përfshi edhe KLD-në. Para miratimit të ligjit objekt kërkese, anëtarët e KLD-së nuk i nënshtroheshin asnjë forme kontrolli apo përgjegjësie, përfshi edhe rastet e shkarkimit. I takon ligjvënësit të kujdeset që të mos lejojë boshllëqe të tilla, sidomos në rastet e organeve të rëndësishme që kanë si funksion garantimin e dhënies së drejtësisë mbi bazë të ligjit dhe Kushtetutës.

3.4 Mënyra e zgjedhjes së zëvendëskryetarit të KLD-së nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga

Kuvendi, nuk bie ndesh me nenin 147 të Kushtetutës. Ligjvënësi, duke parashikuar si mundësi të vetme zgjedhjen e zëvendëskryetarit mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se ka zbatuar detyrimin që rrjedh nga neni 147/3 i Kushtetutës. Detyra e zëvendëskryetarit është një punë me kohë të plotë dhe si e tillë nuk mund të ushtrohet njëherazi me një detyrë tjetër me kohë të plotë. Kështu që e vetmja mundësi mbetet zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi. Kjo ka qenë deri tani edhe praktika e KLD-së.

3.5 Pretendimi se pezullimi nga detyra e gjyqtarit kur merr cilësinë e të pandehurit cenon pavarësinë e gjyqësorit, nuk qëndron, pasi funksioni që mban gjyqtari është mjaft i rëndësishëm dhe si i tillë mund të ushtrohet vetëm në kushtet e besimit që ai reflekton në publik për pastërtinë e figurës së tij si gjyqtar. Gjithashtu, mosushtrimi i detyrës së tij nga momenti që merret si i pandehur është një garanci se nuk do të ketë situata të konfliktit të interesit midis kolegëve. Gjithashtu, ligji parashikon garancitë ligjore në rast se gjyqtari deklarohet i pafajshëm. Ai kthehet në detyrë dhe përfiton pagesën për të gjithë periudhën që ka qenë i pezulluar.

3.6 Lidhur me kërkesën për pezullim, subjekti i interesuar, Kuvendi, propëson se nuk ka argumente të mjaftueshme se pasojat që do të vijnë nga zbatimi i ligjit do të jenë të pariparueshme dhe cenojnë bazat e shtetit të së drejtës. Si e tillë, ajo duhet rrëzuar.

4. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave, parashtrou se:

4.1 Pretendimi se cenohet pavarësia e gjyqësorit nga heqja e kompetencës KLD-së për të verifikuar zgjedhshmërinë e anëtarëve të saj, nuk qëndron. Ndryshimet në ligjin objekt kërkese janë bërë me qëllim për qasjen dhe përshtatjen me funksionet e tjera kushtetuese (si p.sh gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese) lidhur me parashikimin shterues të rasteve të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLD-së, raste të cilat nuk ishin të parashikuara deri tani. Edhe me ligjin e ri, rastet e mbarimit të mandatit të anëtarëve deklarohen nga KLD-ja. Ndërsa kur kemi të bëjmë me rastet e shkarkimit, këto duhet t'i lihen një organi tjetër, i cili



zakonisht është organi i emërtesës. Nëse edhe rastet e shkarkimit do t'i lireshin KLD-së, një gjë e tillë do të sillte cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi vetë organi në mënyrë të pakontrolluar do të vendoste për shkarkimin e anëtarëve të tij.

4.2 Përsa u takon rasteve të shkarkimit të anëtarëve të KLD-së, parashikimi i ligjit e vendos këtë organ në një rang me të gjitha organet e tjera kushtetuese. KLD-ja para miratimit të këtij ligji, ka qenë i vetmi organ, anëtarët e të cilit nuk mund të shkarkoheshin. Parimi i ndarjes së pushteteve parashikon që organet të jenë të pavarura, por edhe të kontrollohen respektivisht nga organet e emërtesës ose të tjera të ngarkuara me këtë funksion. Rastet e parashikuara për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk cenojnë as parimin e sigurisë juridike, pasi ato janë thujse të njëjta me rastet e shkarkimit të anëtarëve të organeve të tjera kushtetuese.

4.3 Kompetenca e Presidentit të Republikës për të zgjedhur zëvendëskryetarin e KLD-së, duke përcaktuar rrethin e anëtarëve mes të cilëve duhet të zgjidhet, nuk cenohet. Roli i zëvendëskryetarit të KLD-së është një funksion që duhet të ushtrohet me kohë të plotë. Si i tillë ai nuk mund të ushtrohet nga anëtarë që mbajnë ndërkohë një detyrë tjetër. Nëse heqin dorë nga detyra që mbajnë, atëherë ata nuk mund të jenë anëtarë të KLD-së, pasi këtë formulë parashikon neni 147 i Kushtetutës. Si rrjedhim, e vetmja mundësi mbetet zgjedhja e zëvendëskryetarit mes anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi. Ligji ka bërë vetëm një detajim të nenit 147/3 të Kushtetutës dhe si i tillë është tërësisht në përputhje me të dhe me vendimin nr.14/2006 të Gjykatës Kushtetuese.

4.4 Edhe pretendimi tjetër i kërkuesit se pezullimi nga detyra i gjyqtarit kur merret i pandehur cenon pavarësinë e gjyqësorit dhe shkel garancitë e gjyqtarit në detyrë, nuk është i bazuar. Është e vërtetë që ligji bën një diferencim të gjyqtarit nga funksionet e tjera, duke e pezulluar atë kur merret i pandehur, por ky diferencim është legjitim dhe bëhet për një arsye publike. Interesi publik konsiston në krijimin e besimit te publiku se drejtësia nuk do të jepet nga persona që janë në ndjekje penale. Gjithashtu, ligji ka parashikuar edhe garancitë e gjyqtarit, i cili nëse shpallet i pafajshëm jo vetëm që kthehet në

detyrë, por merr edhe pagën për të gjithë periudhën që ka qenë i pezulluar.

5. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, parashitroi se:

5.1 Heqja e kompetencës së KLD-së për të verifikuar mandatet e anëtarëve të tij bie ndesh me nenin 7 të Kushtetutës që garanton ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Çdo organ që përbëhet nga funksionarë të zgjedhur ka të drejtë të bëjë vetë, i pavarur nga organe të tjera, verifikimin e mandateve të anëtarëve të tij. Kështu garantohet pavarësia e tij. Me ligjin e ri i hiqet kjo mundësi KLD-së duke i hequr edhe të drejtën për të verifikuar rastet kur një anëtar i KLD-së i zgjedhur nga Kuvendi ose nga KGJK nuk i ka plotësuar kriteret formale për të qenë anëtar i KLD-së.

5.2 Ligji i ri parashikon rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së, duke ndikuar në pavarësinë e gjyqësorit. Rastet e shkarkimit nuk janë të qarta, disa prej tyre janë të njëjta me rastet e përfundimit të mandatit. Gjithashtu, mungojnë edhe procedurat e sakta që do të zbatohen në rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së.

5.3 Ligji bie ndesh edhe me parimin e sigurisë juridike, pasi krijon mundësinë që mandati i anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi të ndërpritet sa herë që ndryshojnë mazhorancat politike në parlament, duke e bërë këtë organ kushtetues të ndikueshëm politikisht.

5.4 Rregullimi i ri ligjor, sipas të cilit zëvendëskryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, nuk është i autorizuar nga Kushtetuta. Neni 147/3 i saj nuk e ka autorizuar ligjvënësin të rregullojë mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit. Ky rregullim, gjithashtu, i heq të drejtën anëtarit të zgjedhur nga KGJK-ja që potencialisht të jetë zëvendëskryetar, duke vendosur një kufizim me ligj dhe pa autorizimin e Kushtetutës. Në këtë mënyrë ligji cenon hierarkinë e akteve normative, të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës.

5.5 Pezullimi nga detyra i gjyqtarit kur merret i pandehur bie ndesh me parimin e palëvizshmërisë nga detyra të gjyqtarit si dhe me prezumimin e pafajësisë dhe sigurinë juridike. Rastet kur gjyqtari nuk mund të ushtrojë më detyrën e tij janë të parashikuara në Kushtetutë dhe ato nuk mund të shtohen me ligj. Kushtetuta nuk përmend në asnjë dispozitë të saj pezullimin



nga detyra të gjyqtarit. Për më tepër që edhe sikur të parashikohej pezullimi nga detyra, kjo masë duhet të vendoset nga KLD-ja dhe jo automatikisht, pasi nuk jep asnjë garanci për gjyqtarit që nuk do të ketë raste abuzimi. Rregullimi i ri ligjor nuk vendos afate maksimale deri kur do të jetë në fuqi masa e pezullimit nga detyra. Në këtë rast nuk garantohet prezumimi i pafajësisë për gjyqtarin dhe siguria juridike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit²

6. Sipas nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Çështjen e legjitimitimit (locus standi) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Për sa i përket kërkuarit, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ai legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën sipas objektit të kërkesës. Kërkuari përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si i tillë ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit

7. Kërkuari ka kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kërkesë, duke argumentuar se zbatimi i këtyre dispozitave do të sillte një dëm të pariparueshëm për anëtarët e KLD-së që do t’u verifikohet mandati sipas ligjit të ri. Nisja e procedurës së shkarkimit dhe pezullimi nga detyra sjell pasoja negative dhe të pariparueshme për anëtarët e KLD-së dhe për themelet e shtetit të së drejtës në përgjithësi.

8. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt

shqyrtimi të paraqitur nga kërkuari dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Gjykata në datën 15.10.2014 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, si të pabazuar.

C. Për pretendimin se procedura e miratimit të ligjit bie ndesh me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit

9. Kërkuari ka pretenduar se ligji objekt shqyrtimi është miratuar në kundërshtim me urdhërimet e neneve 81/2 dhe 83/3 të Kushtetutës. Sipas tij, ligji është miratuar në Kuvend me procedurë të përshpejtuar, e cila nuk lejohet të aplikohet për ligje që kërkojnë shumicë të cilësuar. Gjithashtu, sipas kërkuarit, procedura e miratimit të ligjit nuk ka respektuar rregulloren e Kuvendit, duke anashkaluar nenet 69-70 të saj për sa i takon përfshirjes së projektligjit në kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe shqyrtimit paraprak të tij në komisionet përkatëse.

10. Subjekti i interesuar, Kuvendi, parashtroi se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar, pasi procedurat parlamentare janë kryer në përputhje me Kushtetutën dhe rregulloren e Kuvendit. Ligji nuk është miratuar me procedurë të përshpejtuar, por me procedurë normale ligjvënëse. Për sa i takon zbatimit të dispozitave të rregullores, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, ato nuk janë dispozita të nivelit kushtetues, por rregulla që shërbejnë për organizimin e punës së organit ligjvënës dhe nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Megjithatë rezulton se procedurat kanë qenë të rregullta.

11. Gjykata, nisur nga parashtrimet e palëve dhe materialet e paraqitura prej tyre, konstaton se në datën 30.6.2014 Konferenca e Kryetarëve vendosi miratimin e programit të punës për periudhën 4-31 korrik 2014. Me propozim të Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe Administratës Publike, shqyrtimi i projektligjit u përfshi në program. Në datën 16.07.2014 ky komision e ka përfshirë shqyrtimin e ligjit në rend dite. Po në këtë datë është bërë miratimi në parim i projektligjit. Miratimi nën për nen i tij është bërë në datën 22.07.2014. Në datën 24.07.2014 projektligji është përfshirë në rendin e ditës të punimeve të seancës parlamentare. Në këtë seancë nuk u arrit votimi dhe seanca u shty

² Gjyqtari V. Kristo votoi kundër legjitimitetit të kërkuarit, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese, pasi duke bojkotuar punimet e Kuvendit, ditën që do të merrej në shqyrtim ligji i kundërshtuar, në zbatim të një mandati detyrues që buron nga qenia e grupit të deputetëve anëtarë të një partie politike, ata kanë vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe në këtë kuptim nuk mund të përfitojnë nga e drejta që ju njeh neni 134/1/c i Kushtetutës.



për në datën 31.07.2014, datë në të cilën projektligji u miratua.

12. Gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin se ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar. Projektligji është futur në programin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4-31 korrik 2014, i cili është miratuar me konsensusin e partive të tjera parlamentare. Bazuar në rregulloren e Kuvendit, programi i punimeve është akti i vetëm nëpërmjet të cilit një çështje përfshihet për t'u shqyrtuar në Kuvend. Vetëm me miratimin e këtij akti lind detyrimi i komisioneve të posaçme për të shqyrtuar projektligjin. Megjithatë, edhe pas miratimit të programit të punimeve, projektligji nuk është futur në shqyrtim të komisionit pa kaluar afati dyjavor nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Më pas është futur në rendin e ditës së komisionit përkatës duke vazhduar me hapat e zakonshëm të miratimit të një projektligji.

13. Gjykata çmon se kalendari i punimeve të Kuvendit është një akt i brendshëm për disiplinimin e punës së tij dhe në këtë këndvështrim, nëse çështjet e planifikuara për t'u shqyrtuar në kalendarin 3 javor nuk arrijnë të shqyrtohen për arsye të ndryshme, ato i kalojnë kalendarit në vijim. Vetëm thjesht fakti i mosshqyrtimit brenda këtij kalendari nuk mund të konsiderohet shkelje e tillë që ta bëjë aktin e miratuar antikushtetues, nëse gjatë procesit të votimit nuk ka mangësi të tjera që do të mund të ngrinin dyshime mbi kushtetutshmërinë e tij (*shih vendimin nr.21/2008 të GJK-së*).

14. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për mosrespektim të procedurave parlamentare gjatë miratimit të ligjit objekt kërkese nuk është i bazuar.

D. Për pretendimin se heqja e kompetencës së KLD-së për verifikimin e mandateve të anëtarëve të zgjedhur cenon pavarësinë e gjyqësorit

15. Kërkuesi pretendon se neni 3 i ligjit i heq kompetencën KLD-së për të bërë verifikimin e mandatit të anëtarit të KLD-së duke cenuar pavarësinë e këtij organi. Këtij pretendimi i është bashkuar në parashtrimet e veta drejtuar kësaj Gjykate edhe KLD-ja, i cili ka theksuar se mënjanimi i KLD-së nga verifikimi i mandateve të anëtarëve të zgjedhur cenon thelbin e pavarësisë së KLD. Një gjë e tillë nuk i lë asnjë mundësi këtij organi për të konstatuar

eventualisht edhe raste kur një anëtar i zgjedhur mund të mos i ketë plotësuar kriteret formale për t'u zgjedhur anëtar i KLD-së.

16. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, prapësojnë duke argumentuar se Kushtetuta nuk ka parashikuar asnjë dispozitë lidhur me përfundimin e mandatit (përfshi edhe rastin e shkarkimit) të anëtarëve të KLD-së. Për këtë arsye, ligjvënësi duke pasur detyrimin kushtetues për të mos lënë boshllëqe për këtë organ kushtetues, ka marrë nismën për ta plotësuar atë me qëllim që ky organ të mos bëjë përjashtim nga organet e tjera kushtetuese (si Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Avokati i Popullit etj.).

17. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk arriti ta ngrrejë në nivelin kushtetues këtë pretendim. Për këtë arsye, Gjykata e gjen atë të pabazuar.

Ç. Për pretendimin se rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së cenojnë pavarësinë e gjyqësorit

18. Kërkuesi pretendon se neni 4 i ligjit që parashikon rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së cenon parimin e ndarjes së pushteteve dhe dobëson vetëqeverisjen e gjyqësorit. Ligji objekt kërkese nuk bën dallime ose specifikime lidhur me rastet e shkeljes së rëndë të ligjit si shkak për shkarkimin e anëtarit të KLD-së, duke lënë vend për abuzim dhe duke mosgarantuar ruajtjen e paprekshmërisë së këtij organi kushtetues.

19. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, parashtruan se neni 4 i ligjit nuk cenon parimin e ndarjes dhe balancimit. KLD-ja, si organ kushtetues, megjithëse është i pavarur, nuk mund të jetë i përjashtuar nga kontrolli i ndërsjellë të organeve të pushteteve të tjera, siç parashikohet edhe nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Për këtë arsye, ligjvënësi ka plotësuar një boshllëk lidhur me këtë organ, në mënyrë që askush të mos jetë i pakontrollueshëm gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

20. Gjykata vëren se neni 4 i ligjit objekt shqyrtimi ka shtuar një dispozitë të re në ligjin për KLD-në (konkretisht nenin 7/1) me këtë parashikim:

"Shkarkimi i anëtarit

Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ose nga Kuvendi në këto raste:



- a) për shkëlqje të Kushtetutës dhe të ligjit;
- b) për kryerjen e një krimi;
- c) për paafhtësi mendore dhe fizike;
- e) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;
- d) vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e parashikuara në ligj.”

21. Para këtij ndryshimi, në ligjin për KLD-në nuk kanë qenë të parashikuara rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së. Edhe Kushtetuta nuk ka të parashikuar ndonjë rast shkarkimi të tyre por vetëm zgjedhjen dhe kohën e qëndrimit në detyrë. Duke iu referuar materialit të paraqitur në Komisionin e Ligjeve nga iniciatorët e projektligjit si dhe raportit të Komisionit të Ligjeve drejtuar Kuvendit (seancës plenare) rezulton se qëllimi i këtij parashikimi ka qenë plotësimi i boshllëkut ligjor që ka ekzistuar deri sot, pasi KLD është i vetmi organ kushtetues për të cilin nuk janë parashikuar raste të shkarkimit.

22. Gjykata është shprehur më parë se KLD-ja, si organ kushtetues i pavarur nga legjislativi dhe ekzekutivi, vendos, ndër të tjera, edhe për transferimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, për përgjegjësinë disiplinore të tyre si dhe i propozon Presidentit të Republikës për emërim, kandidaturat për gjyqtarë. KLD-ja është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, KLD-ja përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në KLD, kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (neni 147/4 i Kushtetutës). Ai është konceptuar si organ i pavarur, cilësi kjo që karakterizohet nga mënyra e formimit të tij, me pjesëmarrjen e kreut të shtetit dhe figurave më të larta të gjyqësorit (kryetari të Gjykatës së Lartë), përfaqësuesit të ekzekutivit (Ministrit të Drejtësisë) si dhe përfaqësuesve të ligjvënësit (3 anëtarë). Kjo përbërje jo vetëm synon pavarësinë e tij nga të gjitha pushtetet e tjera por pasqyron edhe ndarjen dhe balancimin e pushteteve në KLD (*sbih vendimin nr.14/2006 të GJK-së*).

23. Parimi i ndarjes së pushteteve, ashtu si dhe parimet e tjera kushtetuese, nuk është qëllim në

vetvete, por ka si funksion të ndihmojë në realizimin e objektivit, që është shpërndarja e pushtetit në disa mbajtës të tij, duke përfaqësuar kështu interesa të ndryshëm për të siguruar reciprokisht një balancë sa më të madhe në ushtrimin e pushtetit. Bashkëveprimi i mbajtësve të pushtetit duhet të sigurojë shanse më të mëdha për marrjen e vendimeve sa më të drejta për bashkësinë. Prandaj konsiderohet domosdoshmëri që parimi i ndarjes së pushteteve, pavarësisht ndryshimit të forcave politike në pushtet, të mbetet mbizotërues dhe të mos cedojë për arsye të papërligjura.

24. Element i rëndësishëm i parimit të ndarjes së pushteteve është edhe vetëqeverisja e gjyqësorit, e cila realizohet nëpërmjet KLD-së. Megjithatë, pavarësisht faktit se ligjvënësi ka parashikuar një organ të posaçëm për administrimin e sistemit gjyqësor, ai nuk mund të jetë krejtësisht i shkëputur nga bashkëveprimi i pushteteve të tjera. KLD-ja është një organ që vendos për emërimin, transferimin, trajnimin, shkarkimin dhe masat e tjera disiplinore të gjyqtarëve. Gjatë këtyre procedurave është e rëndësishme pjesëmarrja aktive e Ministrit të Drejtësisë (në rastin e propozimit të masave disiplinore), e Presidentit të Republikës (në rastin e emërimit) si dhe e tre anëtarëve të zgjedhur prej Kuvendit. Por në shumicë KLD-ja është e përbërë nga gjyqtarë (9 të zgjedhur nga KGJK-ja dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë).

25. Gjykata çmon se Kushtetuta garanton pavarësinë e KLD-së me qëllim funksionimin sa më mirë të sistemit të drejtësisë. Pavarësia e tij sjell pasoja direkte tek dhënia e drejtësisë dhe cilësia e saj. Në këtë kuptim, mënyra e formimit të këtij organi është parashikuar në Kushtetutë, me qëllim mosdeformimin (pakësim, shtim) me ligj të këtij aspekti, duke i dhënë një garanci më të madhe nga ndryshimi i vullnetit politik të ligjvënësit.

26. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithëse disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta, nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të



organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm parime dhe kritere bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por, Kushtetuta, përveç kësaj, mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm.

27. Gjykata ka theksuar në praktikën e saj se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë duhet që aktet që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative.

28. Gjykata çmon se çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Nga ky rregull rrjedh, gjithashtu, detyrimi se të gjitha organet gjatë ushtrimit të detyrës së tyre duhet të mbajnë përgjegjësinë që u takon në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre si funksionarë publikë. Në këtë kuptim, kushdo që ushtron një funksion publik nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia. Për të realizuar efektivisht këtë aspekt të zbatimit të parimeve të shtetit të së drejtës, kuadri normativ i një shteti parashikon edhe rastet ekstreme të përgjegjësisë, pra rastet kur funksionari mund të shkarkohet për shkak të mosushtrimit të përgjegjshëm të detyrës me të cilën është ngarkuar. Natyrisht, kur bëhet fjalë për funksionarë të cilët vetë Kushtetuta i ka veshur me mbrojtje të posaçme, për shkak të rolit që ata luajnë në një shtet të së drejtës, atëherë rastet e shkarkimit duhet të lidhen gjithmonë edhe me parashikimin e shkeljeve konkrete të përcaktuara qartë, me qëllim që ato të moskonfondohen me raste të tjera, për të cilat masa e përgjegjësisë është e ndryshme nga shkarkimi (p.sh. mbarimi i mandatit ose ulje në detyrë etj). Gjithashtu, ato duhet të shoqërohen

me garanci konkrete procedurale, me qëllim që zyrtari i shkarkuar të gëzojë një proces të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës. Të gjitha këto elementë garancie kanë si qëllim primar jo thjesht mbrojtjen e zyrtarit, por të funksionit që ai ushtron për të bërë të mundur shmangien e abuzimeve ose vendosjen nën presion të zyrtarit.

29. Gjykata çmon se funksioni kushtetues i anëtarit të zgjedhur të KLD-së (funksion administrativ/ekzekutiv), duke qenë se është i ndryshëm nga funksionet e tjera kushtetuese (funksioni i gjyqtarit për dhënien e drejtësisë), edhe garancitë si dhe rastet e kontrollit të përgjegjshmërisë nuk janë të njëjta. Për çështjet/marrëdhëniet që nuk janë të rregulluara nga Kushtetuta, ligjvënësi nuk ndalohej të ndërhyjë, por në çdo rast ai duhet të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese përkatëse.

30. Nisur nga sa më lart, referuar çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se edhe anëtari i KLD-së mban përgjegjësi si çdo funksionar tjetër. Gjatë procesit të verifikimit të veprimtarisë së tij, nëse ka qenë në përputhje apo jo me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ai, ashtu si çdo funksionar tjetër, duhet të gëzojë disa garanci kur ndaj tij fillon një procedurë shkarkimi. Të tilla garanci janë të parashikuara edhe për funksionarë të tjerë, si Prokurori i Përgjithshëm (neni 149/2), anëtari i Gjykatës së Lartë (neni 140) dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese (neni 128). Nisur nga ky fakt, duke iu referuar nenit 4 të ligjit objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se një nga shkaqet e shkarkimit të anëtarit të KLD-së është edhe shkelja e ligjit, rast i cili në këndvështrimin e Gjykatës rezulton të jetë i përgjithshëm dhe evaziv. Gjykata shpreh qëndrimin se një anëtar i një organi kushtetues mund të shkarkohet për shkelje të ligjit, të cilat duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë rëndë interesat e shtetit apo ato shoqërore, pra të sjellin pasoja të rënda. Ato (shkeljet), gjithashtu, duhet të kenë lidhje me ushtrimin e detyrës nga funksionari.

31. Gjithashtu, Gjykata vëren se neni 4 parashikon si shkaqe për shkarkim të njëjtat shkaqe, të cilat në nenin 7 janë listuar si raste të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLD-së. Kështu, neni 7 dhe neni 4, njëkohësisht, parashikojnë si shkak për mbarimin e mandatit dhe për shkarkimin e anëtarit të KLD-së:



dënimin me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; paaftësinë mendore dhe fizike; vërtetimin e rasteve të papajtueshmërisë. Gjykata konstaton se me këtë formulim, kjo dispozitë e ligjit bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, pasi rastet për të cilat mund të shkarkohet anëtari i KLD-së janë të paqarta, konfuze.

32. Gjykata vlerëson se rastet e mbarimit të mandatit dhe ato të shkarkimit duhet të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra, pasi edhe shkaqet që çojnë te përfundimi i funksionit të zyrtarit për secilin rast janë të ndryshme. Mbarimi i mandatit të një funksionari lidhet zakonisht me kohën gjatë të cilës ai duhet të ushtrojë mandatin apo me ngjarje që e bëjnë të pamundur ushtrimin e mëtejshëm të detyrës, si p.sh. paaftësia fizike ose mendore, marrja e një detyre të re nga ana e zyrtarit, dorëheqja e tij nga detyra etj. Ndërsa rastet e shkarkimit lidhen me sjelljen e zyrtarit, e cila mund të jetë jo në pajtim me rregullat e ushtrimit të tij, si p.sh. shkelja e ligjit, mosushtrimi si duhet i detyrës, kryerja e një vepre penale gjatë ushtrimit të detyrës etj. Pra, në rastin e parë zyrtarit i mbaron mandati për shkaqe që nuk bien ndesh me rregullat apo ligjin, por thjesht për shkak të ngjarjeve që passjellin pamundësinë e tij për të ushtruar më tej detyrën. Në rastin e dytë, pra të shkarkimit, zyrtari ndëshkohet për sjelljen e tij jo konform ligjit dhe rregullave, duke e larguar nga detyra. Ligji duhet të jetë i qartë se kur do i referohet rastit të shkarkimit “për shkak të kryerjes së një krimi” dhe kur “dënimin me vendim të formës së prerë të gjykatës” si shkak për përfundimin e mandatit.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se shkaqet e parashikuara në nenin 4 të ligjit për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk janë të qarta dhe nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tyre. Në këto kushte, kjo dispozitë nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, përse i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje, dhe si e tillë është antikushtetuese dhe duhet shfuqizuar.

E. Për pretendimin se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi bie ndesh me nenin 147 të Kushtetutës

34. Kërkuesi pretendon se neni 7 i ligjit objekt kërkesë, që parashikon zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes

anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, është interpretim i ngushtë i nenit 147/3 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë bie ndesh me të. Kushtetuta është mjaftuar vetëm me parashikimin që ai të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KLD-së pa bërë dallime në mënyrën e zgjedhjes së tyre. Sipas kërkuetit, kjo gjë është në tejkallim të parashikimit kushtetues. Këtij pretendimi i bashkohet edhe KLD-së në parashtrimet e veta.

35. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, parashtrajnë se për shkak të rolit që ka zëvendëskryetari i KLD, nuk mund të zgjidhet nga pjesa tjetër e anëtarëve, por vetëm nga 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, pasi anëtarët e tjerë të KLD-së mbajnë edhe funksione të tjera të larta. Mosmbajtja e dy funksioneve me kohë të plotë njëherazi nga një person dhe sidomos nga një gjyqtar është një detyrim që rrjedh edhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, ligji ka mishëruar vullnetin e shprehur nga Kushtetuta në nenin 147/3 dhe nuk e ka tejkalluar atë.

36. Neni 147/3 (fjalja e parë) i Kushtetutës parashikon: “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e e tij një zëvendëskryetar.*”. Neni 7 i ligjit objekt kërkesë parashikon: “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga rradhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një zëvendëskryetar.*”.

37. Gjykata konstaton se ligji objekt kërkesë ka parashikuar që Presidenti e zgjedh zëvendëskryetarin e KLD-së mes 3 anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi. Gjykata vlerëson se si kërkuesi, ashtu edhe subjektet e interesuara nuk e vunë në dyshim faktin se funksioni i zëvendëskryetarit të KLD-së është një detyrë që ushtrohet me kohë të plotë. Nisur nga ky fakt, Gjykata nuk e sheh me vend të ndalet në sqarimin e kësaj premise.

38. Gjykata vlerëson se është e nevojshme t'i referohet vendimit të saj të mëparshëm lidhur me rolin dhe natyrën e punës së anëtarëve të KLD-së. Kështu, Gjykata ka deklaruar se funksionarët *ex officio* të KLD-së: Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë dhe 9 gjyqtarët e zgjedhur nga KGJK-ja, për shkak të mbajtjes së funksioneve të tjera, nuk mund të zgjidhen zëvendëskryetarë të KLD-së. Gjithashtu, ajo ka theksuar se “...sipas nenit 143 të Kushtetutës “*Qenia*



gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”. Nga përmbajtja e kësaj norme del që detyra e parë dhe kryesore është qenia gjyqtarë në kuptimin që gjyqtarët japin vendime e bëjnë drejtësi në mënyrë të vazhdueshme. Lidhur me këtë detyrë, Kushtetuta ka bërë përjashtim për sa i përket veprimtarisë jo permanente të tyre në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqtarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues. Përjashtimet nga rregullimi kushtetues nuk mund të vendosen me ligj. Vetë kushtetutëbërësi, kur e ka gjykuar të arsyeshme, ka bërë përjashtime në mënyrë të posaçme. Kështu, ai ka lejuar shprehimisht edhe anëtarësinë e Presidentit të Republikës ose të Ministrit të Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, megjithëse nenet 89 e 103/2 të Kushtetutës kanë përcaktuar përkatësisht se ai (Presidenti i Republikës) “nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike”, ose “Ministri i Drejtësisë nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore”. (shih vendimin nr. 14/2006 të GJK-së).

39. Gjykata nuk sheh asnjë shkak për të ndryshuar praktikën e saj të mëparshme lidhur me këtë çështje, pasi nuk ndodhet para rrethanave të ndryshme ligjore ose faktike. Gjithashtu, ajo mban parasysh se edhe praktika e KLD-së, që prej krijimit të tij, tregon se zëvendëskryetari i KLD-së është caktuar gjithmonë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur prej Kuvendit. Nisur nga këto premisa, Gjykata çmon se nisur nga pamundësia që funksionarët të mbajnë dy funksione me kohë të plotë njëherazi, rrjedh përfundimi se kandidatë potencialë për t’u zgjedhur në detyrën e zëvendëskryetarit të KLD-së janë vetëm 3 (tre) anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi.

40. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, nuk bie ndesh me nenin 116 dhe nenin 147/3 të Kushtetutës.³

DH. Për pretendimin se pezullimi i gjyqtarit nga detyra kur merret i pandehur cenon pavarësinë e gjyqësorit.

41. Kërkuksi pretendon se përmbajtja e nenit 10/2 të ligjit objekt shqyrtimi, i cili parashikon pezullimin e gjyqtarit automatikisht nga detyra, kur ai merret i pandehur për një vepër penale, bie

ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe sigurisë juridike duke mosgarantuar një proces të rregullt ligjor. Një gjë e tillë prek drejtpërdrejt pavarësinë e gjyqësorit. Sipas tij, ky parashikim anashkalon edhe KLD-në, i cili duhet të vendosë automatikisht pezullimin e gjyqtarit. Këtij pretendimi i bashkohet edhe KLD-ja.

42. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se parashikimi i kësaj mase në ligj ishte i nevojshëm, pasi një gjyqtar që merr cilësinë e të pandehurit nuk mund të jetë më i besueshëm për dhënien e drejtësisë. Gjithashtu, pezullimi nga detyra e gjyqtarit që merret i pandehur i shërben edhe shmangies së abuzimeve të mundshme që mund të reflektohen për shkak të qenies së tij gjyqtar (shih procesverbalin e Komisionit të Ligjeve, datë 22.7.2014, fq.13).

43. Neni 10/2 i ligjit objekt shqyrtimi parashikon: “Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.” Një rregullim i ngjashëm është i parashikuar edhe në nenin 29 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon: “... Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë...Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.”.

44. Gjykata vëren se vendosja e masës së pezullimit të gjyqtarit nga detyra, kur ndaj tij fillon një procedim penal, ka qenë e parashikuar në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Ky ligj, ndryshe nga sa pretendon kërkuksi në parashtrimet e tij, parashikon se kur gjyqtari deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ai kthehet në punë dhe përfiton pagën e plotë nga momenti i pezullimit të tij.

45. Gjykata vlerëson se parashikimi i situatës kur vendoset pezullimi i gjyqtarit në ligjin për organizimin gjyqësor është një dispozitë e qartë, pasi parashikon jo vetëm pezullimin nga detyra por edhe pasojat që vijnë nëse gjyqtari deklarohet i pafajshëm, si garanci për ushtrimin e detyrës së tij. Duke qenë se këto garanci janë të

³ Votuan kundër: B. Dedja, V. Kristo, A. Xhoxhaj dhe G.Dizdari.



parashikuara në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor, i cili është dhe ligji specifik për gjyqtarët, ku parashikohet statusi i tyre, referenca për këtë qëllim duhet të bëhet tek ai ligj. Rregullimi i bërë në nenin 10 të ligjit për KLD-në që kundërshtohet nuk lidhet me garancitë e gjyqtarit, pasi një gjë e tillë është e parashikuar në ligjin specifik (për pushtetin gjyqësor), por ka të bëjë me aspektin e ushtrimit të kompetencës së KLD-së, si organi që është ngarkuar me marrjen e masës së pezullimit nga detyra të gjyqtarit dhe heqjen e kësaj mase në rastin e deklarimit të tij të pafajshëm dhe kthimin e tij në detyrë. Për këtë arsye, në çdo rast përsa u takon elementëve të statusit të gjyqtarëve referimi duhet bërë te ligji specifik, pra te ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor, ku parashikohen të gjitha rastet që lidhen me ushtrimin e detyrës së gjyqtarit.

46. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se vendosja automatike e masës së pezullimit bie ndesh me garancinë se gjyqtari është i palëvizshëm nga detyra dhe parimi i sigurisë juridike, Gjykata nënvizon se statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat, të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqësorit janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 40/2014; nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 11, datë 27.05.2004 të GJK*).

47. Gjykata vlerëson se parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij

rregullimi ai mund të vendosë edhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancisë (*shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të GJK*).

48. Në rastin konkret, dispozita ligjore objekt shqyrtimi, duke e lidhur fillimin e procedimit penal ndaj gjyqtarit me pezullimin e tij nga detyra deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë nga gjykata, ka bërë një ndërhyrje në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson nëse kjo ndërhyrje e ligjvënësit është e përshtatshme në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet, rritjen e besimit të publikut në dhënien e një drejtësie të paanshme dhe të pavarur.

49. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyesh publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë/garanci kushtetuese. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr.40/2014; nr. 2, datë 18.02.2013; nr. 4, datë 23.02.2011 dhe nr. 40, datë 7.7.2014 të GJK*).

50. Në çështjen në shqyrtim, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi, theksoi se ndryshimet kanë pasur si objektiv shmangien e rasteve kur gjyqtarët që ndiqen penalisht të vazhdojnë të ushtrojnë këtë funksion. Një gjë e tillë rrit besimin e publikut tek pushteti gjyqësor. Pezullimi nga detyra në asnjë rast nuk passjell humbjen e statusit të gjyqtarit.

51. Gjykata e sheh të bazuar këtë argument dhe vlerëson se ai respekton parimin e proporcionalitetit. Në jurisprudencën e saj ajo ka



theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi duhet vlerësuar rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës/garancisë së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën/garancinë e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Baraspeshimi i ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 12, datë 14.04.2010 dhe nr. 16, datë 25.7.2008 të GJK*).

52. Në këndvështrim të këtyre kritereve kushtetuese, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, pezullimi i gjyqtarit nga detyra është në funksion të rritjes së besimit të publikut në dhënien e drejtësisë. E drejta e gjyqtarit për të ushtruar detyrën i pakufizuar në kohë së bashku me garancitë e tjera që parashikon neni 138 i Kushtetutës, janë pjesë përbërëse të statusit të gjyqtarit dhe si të tilla i shërbejnë pavarësisë së gjyqësorit. Krahas këtij aspekti, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që ata kanë, pra dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime përsa i takon figurës së tyre. Këtij qëllimi i shërben edhe dispozita e nenit 10/3, e cila zbatohet në bashkëpunim me ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe dispozitat përkatëse të KPP.⁴

53. Në lidhje me pretendimin se shprehjet që përmbajnë dispozitat ligjore objekt shqyrtimi cenojnë parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, Gjykata çmon se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

54. Si përfundim, nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit, për sa i përket papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit objekt shqyrtimi, që ndryshon nenin 7 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, janë të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr.101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtar pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar)

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj

MENDIM PARALEL

1. Bashkohem me shumicën për shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr. 101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, por ndahem përsa i takon argumentit për të cilin u shfuqizua kjo dispozitë, si dhe përsa i takon rrëzimit të dy pretendimeve të kërkuesit lidhur me kompetencën e Presidentit për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së dhe pezullimin nga detyra të anëtarit të KLD-së kur ai merret i pandehur për kryerjen e një vepre penale.

A. Për shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr. 101/2014

2. Shumica argumenton se “...çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Nga ky rregull rrjedh, gjithashtu, detyrimi se të gjithë organet gjatë ushtrimit të detyrës së tyre duhet të mbajnë përgjegjësinë që u takon në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre si funksionarë publikë. Në këtë kuptim, kushdo që ushtron një funksion publik nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia. Për të realizuar

⁴ Votuan kundër: G. Dizdari, F. Hoxha dhe F. Lulo



efektivisht këtë aspekt të zbatimit të parimeve të shtetit të së drejtës, kuadri normativ i një shteti parashikon edhe rastet ekstreme të përgjegjësive, pra rastet kur funksionari mund të shkarkohet për shkak të mosushtrimit të përgjegjshëm të detyrës me të cilën është ngarkuar...Gjykata çmon se funksioni kushtetues i anëtarit të zgjedhur të KLD-së (funksion administrativ/-ekzekutiv), duke qenë se është i ndryshëm nga funksionet e tjera kushtetuese (funksioni i gjyqarit për dhënien e drejtësisë), edhe garancitë, edhe rastet e kontrollit të përgjegjshmërisë nuk janë të njëjta. Për çështjet/marrëdhëniet që nuk janë të rregulluara nga Kushtetuta, ligjvënësi nuk ndalohet të ndërhyjë, por në çdo rast ai duhet të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese përkatëse. Ky detyrim merr rëndësi të veçantë në rastet kur bëhet fjalë për gjyqtarët, pasi kjo çështje është rregulluar shprehimisht dhe në mënyrë shteruese nga neni 147/6 i Kushtetutës...Gjykata vlerëson se edhe anëtari i KLD-së mban përgjegjësi si çdo funksionar tjetër. Gjatë procesit të verifikimit të veprimtarisë së tij nëse ka qenë në përputhje apo jo me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ai, ashtu si çdo funksionar tjetër, duhet të gëzojë disa garanci kur ndaj tij fillon një procedurë shkarkimi...Në përfundim, Gjykata vlerëson se shkaqet e parashikuara në nenin 4 të ligjit për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk janë të qarta dhe nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tyre. Në këto kushte, kjo dispozitë nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, përse i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje.” (prg.28-33 të vendimit).

3. Jam kundër këtij argumenti mbi të cilin shumica shfuqizoi dispozitën e ligjit objekt shqyrtimi. Lidhur me parashikimin e rasteve të shkarkimit të anëtarëve të KLD-së, jam i qëndrimit se kjo dispozitë paraqet probleme të natyrës kushtetuese në këto drejtime:

4. Neni 4 i ligjit objekt shqyrtimi ka shtuar një dispozitë të re në ligjin për KLD-në, konkretisht nenin 7/1 me këtë parashikim:

“Shkarkimi i anëtarit

Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ose nga Kuvendi në këto raste:

- a) për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit;
- b) për kryerjen e një krimi;
- c) për paafësi mendore dhe fizike;
- e) për akte e sjellje që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;
- d) vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e parashikuara në ligj.”

5. Para këtij ndryshimi, në ligjin për KLD-në nuk kanë qenë të parashikuara rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së. Gjithashtu, neni 147 i Kushtetutës nuk parashikon asnjë rast shkarkimi të anëtarëve të KLD-së, por vetëm zgjedhjen dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tyre. Duke iu referuar materialit të paraqitur në Komisionin e Çështjeve Ligjore dhe të Administratës Publike nga nismëtarët e projektligjit, si dhe raportit të atij Komisioni drejtuar Kuvendit (në seancë plenare), rezulton se qëllimi i këtij parashikimi ka qenë plotësimi i boshllëkut ligjor që ka ekzistuar deri sot, pasi vetëm për këtë organ kushtetues nuk ka pasur parashikim konkret për rastet e shkarkimit dhe të përfundimit para kohe të mandatit (fq. 19-20 e procesverbalit të Komisionit të Çështjeve Ligjore, datë 16.7.2014, fq.10 e procesverbalit të Komisionit të Çështjeve Ligjore datë 22.7.2014).

6. Jam i qëndrimit se parashikimi i rasteve të shkarkimit për organe kushtetuese, kur nuk janë të shprehura në Kushtetutë, nuk mund të parashikohet me ligj. KLD-ja është një organ kushtetues i ngarkuar me funksionin për të emëruar dhe shkarkuar gjyqtarët, si dhe me çështje të tjera që prekin organizimin e sistemit të drejtësisë, sipas parashikimit kushtetues të nenit 147/4. Për këtë qëllim, ai është konceptuar si organ i pavarur, cilësi kjo që karakterizohet nga mënyra e formimit të tij, me pjesëmarrjen e kreut të shtetit dhe të figurave më të larta të gjyqësorit (kryetarit të Gjykatës së Lartë), përfaqësuesit të ekzekutivit (ministrit të drejtësisë), si dhe përfaqësuesve të ligjvënësit (3 anëtarë). Kjo përbërje jo vetëm synon pavarësinë e tij nga të gjitha pushtetet e tjera, por pasqyron edhe ndarjen dhe balancimin e pushteteve në KLD.⁵

7. Nëse Kushtetuta ka urdhëruar garantimin e pavarësisë së KLD-së, kjo është bërë me qëllim funksionimin sa më mirë të sistemit të drejtësisë në tërësi dhe jo të vetë KLD-ja si e tillë. Pra, pavarësia e tij sjell pasojat direkte tek dhënia e drejtësisë. Në këtë kuptim, mënyra e formimit të këtij organi është parashikuar në Kushtetutë me qëllim mosdeformimin (pakësim, shtim) me ligj të këtij aspekti, duke i dhënë një garanci më të madhe nga ndryshimi i vullnetit politik të ligjvënësit. Fakti që Kushtetuta nuk ka

⁵ Shih vendimin nr.14/2006 të GJK.



parashikuar asnjë rast të shkarkimit të anëtarëve të KLD-së të çon në dy përfundime:

8. *Kushtetutbërësi nuk e ka parë të arsyeshme parashikimin e rasteve të shkarkimit jo për të bërë përjashtim për këtë organ kushtetues, por për faktin se anëtarët e KLD-së janë ose gjyqtarë, ose funksionarë të lartë, të cilët, sipas rastit, mund të shkarkohen nga detyra parësore që ushtrojnë sipas dispozitave përkatëse kushtetuese për këtë qëllim.* Kështu, neni 147/6 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të nivelit të parë dhe të dytë. Neni 90/2 parashikon rastet e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Neni 140 parashikon rastet e shkarkimit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, i cili vlen edhe për Kryetarin e saj, si anëtar ex officio i KLD-së. Ministri i Drejtësisë është post politik i ekzekutivit dhe si i tillë ai lidhet me votëbesimin politik të mazhorancës dhe kryeministrit, prandaj normalisht nuk mund të shkarkohet si funksionarët e tjerë. Pra, të gjithë këta anëtarë të KLD-së, duke qenë njëkohësisht mbajtës të funksioneve të tjera shtetërore (për shkak të detyrës me kohë të pjesshme që ushtrojnë si anëtarë të KLD-së), nuk janë të pashkarkueshëm, ndryshe nga sa parashtron Kuvendi. Kjo do të thotë se nëse ata plotësojnë një nga rastet e shkarkimit të parashikuara në dispozitat e sipërpërmendura, ata jo vetëm nuk mund të jenë më mbajtës të detyrës primare të tyre (pra, gjyqtar i të gjitha niveleve, President i Republikës), por nuk mund të jenë as anëtarë të KLD-së. Pra, shkarkimi i tyre nga funksionet primare passjell përfundimin e mandatit të tyre si anëtarë të KLD-së. Nëse një anëtar i KLD-së do të shkarkohej sipas ligjit objekt shqyrtimi, atëherë ai sërish do të duhej të shkarkohej edhe nga funksioni primar i tij gjyqtar apo President, sepse shkaqet, të cilat ligji i lidh me shkarkimin, janë të njëjta me ato që parashikon Kushtetuta për funksionet kryesore që bartin anëtarët e KLD-së. Pra, qëllimi i përfshirjes së rasteve të shkarkimit në ligjin për KLD-në jo vetëm humbet kuptimin, por edhe është i pazbatueshëm, pasi detyra që mbajnë anëtarët e KLD-së duke qenë me kohë të pjesshme, nuk mund të lidhet me raste të tjera shkarkimi tej atyre që parashikohen për funksionin primar të tyre.

9. *Kushtetuta nuk mund të parashikojë raste shkarkimi të dyfishta për të njëjtin funksionar.* Mbajtja e dy funksioneve në një shtet nuk është rregull,

por përjashtim. Ky parim njihet ndryshe si papajtueshmëri. Koncepti i papajtueshmërisë në legjislacione të ndryshme është i përfshirë pjesërisht në kushtetutë, pjesërisht në ligje të veçanta. Papajtueshmëri me funksionin do të thotë që funksionari nuk lejohet të ushtrojë detyrë tjetër.⁶

10. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në praktikën e saj se për çdo rast, kur rregullimi parashikohet shprehimisht prej Kushtetutës, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë, nuk është i nevojshëm referimi tek kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative.⁷

11. Në vijim të kësaj logjike juridike, duke u kthyer konkretisht tek objekti i çështjes, gjyqtari, për shkak të funksionit që ka, trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues. Si i tillë, ai gëzon, përveç të tjerave, mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitës që parashikon shkarkimin e gjyqtarit, e cila është e ngjashme me atë të shkarkimit të zyrtarëve që ushtrojnë funksione të rëndësishme, duke përdorur të njëjtat standarde për këtë kategori funksionarësh shtetërorë.⁸ Megjithëse Kushtetuta ka parashikuar të njëjtin trajtim për këta funksionarë, një gjë të tillë nuk e kanë bërë ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse. Konkretisht, për zyrtarët e parashikuar nga nenet 128 (gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese), 140 (gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) dhe 149 (Prokurori i Përgjithshëm) të

⁶ Në disa raste lejohet, p.sh, qenia e ministrit edhe deputet (neni 70/2 i Kushtetutës shqiptare). Shih vendimin nr. 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese.

⁷ Vendime të Gjykatës Kushtetuese nr. 212, datë 29.12.2002 dhe nr. 3, datë 20.02.2006.

⁸ Krahaso nenin 147/6 me nenet 128 e 140 të Kushtetutës për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe me nenin 149 për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.



Kushtetutës nuk është bërë asnjë formulim tjetër në ligjet organike të tyre. E kundërta ka ndodhur për gjyqtarët e nivelit të parë dhe të dytë në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

12. Gjykata Kushtetuese në një rast të mëparshëm, kur i është dashur të vlerësojë shtimin e rasteve të shkarkimit të gjyqtarit me ligj përtej atyre që ka parashikuar Kushtetuta, ka konstatuar se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë me ligj rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Shtimi me ligj i rastit të shkarkimit të gjyqtarit për shkelje të disiplinës, është konsideruar prej saj i papajtueshëm me pikën 6 të nenit 147 të Kushtetutës dhe për këtë arsye ajo e ka shfuqizuar. Sipas saj, shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionit që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria.⁹

13. Edhe rasti konkret para kësaj Gjykate mund të shihet në analogji me rastin e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së nga detyra, sipas ndryshimeve të ligjit për KLD-në, objekt shqyrtimi. Përderisa Kushtetuta ka heshtur lidhur me këtë fakt, nuk mundet që ligjvënësi ta rregullojë me ligj. Rregullimi në një rast hipotetik mund të ishte i vlefshëm vetëm përse i takon anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, të cilët nuk janë njëkohësisht funksionarë dhe mund të mos u nënshtrohen rregullave të posaçme përse i takon përfundimit të mandatit ose shkarkimit të tyre.

14. Për sa më lart, jam i qëndrimit se Gjykata duhej ta kishte mbështetur shfuqizimin e nenit 4 të ligjit objekt shqyrtimi mbi linjën se parashikimi i shkaqeve të shtuara për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së, përveç atyre të parashikuara nga Kushtetuta për secilin funksion

primar që ata mbajnë, nuk është në përputhje me vullnetin e kushtetutbërësit, si rrjedhojë sjell cenim të nenit 4 dhe 116 të Kushtetutës.

B. Për pretendimin lidhur me zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm nga 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi

15. Jam i qëndrimit se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes 3 anëtarëve të KLD-së që zgjidhen nga Kuvendi është interpretim i ngushtë i dispozitës kushtetuese 147/3 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë bie ndesh me të. Kushtetuta është mjaftuar vetëm me parashikimin që ai të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KLD-së, pa bërë dallime midis mënyrës së zgjedhjes së tyre apo organit që i zgjedh ata. Në këtë këndvështrim, dispozita objekt shqyrtimi është tejkallim i parashikimit kushtetues dhe nuk respekton as hierarkinë e akteve normative të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës.

16. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në praktikën e saj se Kushtetuta, kur e ka parë të arsyeshme, ka parashikuar shprehimisht zbatimin e drejtpërdrejt të saj ose nuk ka lënë hapësirë rregulluese për ligjvënësin. Si rrjedhim, përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkallohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë nuk është i nevojshëm zbatimi i drejtpërdrejt i saj. Nëse ndodhemi para kësaj situatë, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 212/2002 dhe nr. 3/2006*).

17. Në rastin konkret, ndryshimi që ka sjellë neni 7 i ligjit objekt kërkese është se Presidenti, për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së, duhet të kufizohet mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, pra tek 3 anëtarë. Është e dukshme që dispozita ligjore sjell një kufizim të numrit të anëtarëve të KLD-së që mund të përzgjidhen nga Presidenti si zëvendëskryetar. Pra, sipas ligjit jo të gjithë anëtarët e KLD-së janë potencialisht kandidatë për t'u zgjedhur në postin e zëvendëskryetarit të KLD-së, por vetëm ata anëtarë që zgjidhen nga Kuvendi, gjë që nuk

⁹ Shih vendimin nr. 29/2005 të Gjykatës Kushtetuese.



duket të jetë në pajtim me vullnetin e kushtetutbërësit, i cili nuk ka parashikuar asnjë kufizim për këtë rast.

18. Gjykata Kushtetuese ka tashmë praktikë të konsoliduar lidhur me raportin normë kushtetuese – normë ligjore, duke përcaktuar qartë raportin e varësisë midis tyre, në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së rendit juridik. Sipas saj, *“rendi juridik nuk është një sistem i normave që qëndrojnë pranë njëra-tjetrës ose në të njëjtin rang, ai është një sistem i shkallëzuar në shtresa të ndryshme i përbërë nga norma të ndryshme. E përbashkëta e tyre qëndron tek fakti se vlera e një norme, e cila është krijuar mbi bazën e një norme tjetër, qëndron tek vlera e kësaj të fundit, e cila nga ana e saj është krijuar mbi bazën e një norme tjetër më të lartë. Nëse do t'i referohemi një sistemi konkret normash, atëherë do të marrim si të mirëqenë që Kushtetuta ndodhet në rangun më të lartë të normave. Me këtë do të kemi parasysh Kushtetutën në kuptimin material të saj, pra në kuptimin që kemi një normë pozitive ose disa norma pozitive nëpërmjet të cilave krijohen rregullat e përgjithshme të sjelljes, ose norma të tjera juridike. Këto norma juridike të krijuara mbi bazën e Kushtetutës në kuptimin material të saj nuk përbëjnë gjë tjetër veçse funksionin e ligjvënësit. Rregullimi kushtetues përmban shprehimisht organin i cili autorizohet të nxjerrë ligje ose akte të tjera normative (shih vendimet 3/2006, 14/2006, 29/2005).*

19. Nisur nga sa më lart, duke qenë se neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se dispozitat e saj zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë rregullimi i parashikuar në nenin 147/3 të Kushtetutës mund të zbatohet edhe pa pasur nevojë t'i referohet parashikimit të ri ligjor, i cili në dukje e kufizon efektin e dispozitës kushtetuese. Është parim themelor që rregullimi kushtetues nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti, nëse nuk ka deleguar kompetencë zbatimi tek ligjvënësi. Parë nga ky këndvështrim, është Kushtetuta që autorizon ligjvënësin, dhe ky i fundit, duke respektuar konceptet dhe parimet kushtetuese, të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese nëpërmjet nxjerrjes së normave juridike. Nga kjo buron kërkesa dhe parimi, sipas të cilit, aktet juridike më të ulta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Në rastin konkret rezulton që parashikimi i neni 7 të ligjit objekt shqyrtimi ka kufizuar vullnetin e

kushtetutbërësit të shprehur në nenin 147/3, duke ngushtuar rrethin e personave, mes të cilëve Presidenti mund të zgjedhë zëvendëskryetarin e KLD-së.

20. Në përfundim mendoj se kufizimi i vendosur nga ligjvënësi në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, është bërë në mungesë të një autorizimi kushtetues si dhe passjell një ndryshim në modelin kushtetues përzgjedhës (neni 147/3 i Kushtetutës). Çka bie ndesh me parimin se *“uniteti i sistemit normativ qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës “së krijuar” (shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese) në të cilin “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë” (neni 4/2 i Kushtetutës).*

C. Për pretendimin lidhur me pezullimin nga detyra të anëtarit të KLD-së kur merret i pandehur

21. Neni 10/2 i ligjit objekt shqyrtimi parashikon: *“Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Kështilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.”*

22. Ndërkohë një rregullim i ngjashëm është i parashikuar edhe në nenin 29 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor”*. Pra, rezulton që vendosja e masës së pezullimit të gjyqtarit nga detyra, kur ndaj tij fillon një procedim penal, ka qenë e parashikuar që në vitin 2008 në ligjin për pushtetin gjyqësor. Madje në këtë ligj, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi në parashtrimet e tij lidhur me mospasjen e asnjë garancie për gjyqtarin kur ky deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, janë të parashikuara dhe dy pasoja konkrete nëse gjyqtari shpallet i pafajshëm: a) kthimi në punën e mëparshme dhe b) paga e plotë nga momenti i pezullimit të tij.

23. Mendoj se dispozita e ligjit për organizimin gjyqësor është një dispozitë e plotë, pasi parashikon si rastin e pezullimit, ashtu edhe të pasojave që vijnë nga një vendim gjyqësor që mund ta deklarojë gjyqtarin të pafajshëm, si garanci për ushtrimin e detyrës së tij. Duke qenë se këto garanci janë të parashikuara në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor, i cili është ligji specifik për gjyqtarët, ku parashikohet statusi i tyre, nuk është e qartë arsyeja përse ligjvënësi e



ka parashikuar këtë rregullim edhe në nenin 10 të ligjit për KLD-në objekt shqyrtimi para Gjykatës. Mendoj që neni 10 është i panevojshme dhe krijon probleme në caktimin e ligjit të zbatueshëm në një rast konkret, duke qenë se rregullime të ngjashme janë parashikuar në më shumë se një akt normativ. Një situatë e tillë bie ndesh edhe me parimin e sigurisë juridike përsa i takon qartësisë së normave juridike.

24. Për sa më lart, jam i qëndrimit se Gjykata duhet të kishte shfuqizuar si antikushtetuese edhe nenin 7 dhe 10 të ligjit objekt shqyrtimi.

Anëtar: Gani Dizdari

MENDIM PARALEL

1. Për arsye se ndaj mendim të ndryshëm me shumicën në lidhje me argumentet për pranimin e pretendimit të kërkuesit, 1/5-ës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr. 101, datë 31.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”, çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

2. Gjithashtu, nuk jam dakord me vendimmarrjen e shumicës për rrëzimin e pretendimeve të kërkuesit lidhur me kompetencën e Presidentit të Republikës për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së sipas qëndrimit të shprehur tashmë në mendimin e pakicës së vendimit nr. 16, datë 10.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

3. Shumica ka argumentuar se anëtari i KLD-së mban përgjegjësi si çdo funksionar tjetër. Gjatë procesit të verifikimit të veprimtarisë së tij, nëse ka qenë në përputhje apo jo me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ai, ashtu si çdo funksionar tjetër, duhet të gëzojë disa garanci kur ndaj tij fillon një procedurë shkarkimi. Të tilla garanci janë të parashikuara edhe për funksionarë të tjerë, si Prokurori i Përgjithshëm (neni 149/2), anëtari i Gjykatës së Lartë (neni 140) dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese (neni 128). Në këtë këndvështrim, lidhur me nenin 4 të ligjit objekt shqyrtimi, ajo (shumica) ka konstatuar se shkelja e ligjit, si shkak i shkarkimit të anëtarit të KLD-së, rezulton të jetë e përgjithshme dhe evazive. Ndërsa shkaqet e tjera janë të njëjta me ato të

parashikuara në nenin 7 si raste të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLD-së. Shumica, nisur nga fakti se rastet e mbarimit të mandatit dhe ato të shkarkimit duhet të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra, pasi edhe shkaqet që çojnë te përfundimi i funksionit të zyrtarit për secilin rast janë të ndryshme, ka arritur në përfundimin se shkaqet e parashikuara në nenin 4 të ligjit për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk janë të qarta dhe nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tyre. Në këto kushte, sipas shumicës, kjo dispozitë nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, për sa i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje, dhe si e tillë është antikushtetuese dhe duhet shfuqizuar (*shih paragrafët 30-33 të vendimit*).

4. Arsyetimi i mësipërm i shumicës për shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr. 101/2014 bie ndesh me vullnetin e kushtetutëbërësit dhe me parimet kushtetuese. Në ndryshim nga shumica, jam i mendimit se parashikimi i rasteve të shkarkimit të anëtarëve të organeve kushtetuese për të cilat nuk është shprehur Kushtetuta, nuk mund të bëhet me ligj, qoftë ky edhe me shumicë të cilësuar.

5. Sikurse vëren edhe shumica, Kushtetuta (neni 147) nuk ka parashikuar ndonjë rast për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së, por vetëm zgjedhjen dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tyre (*shih paragrafët nr. 20-21 të vendimit*). Edhe në ligjin për KLD-në, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin objekt shqyrtimi, nuk kanë qenë të parashikuara rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së. Pavarësisht mungesës në parashikimet kushtetuese, neni 4 i ligjit objekt shqyrtimi ka shtuar një dispozitë të re në ligjin për KLD-në (konkretisht nenin 7/1), i cili parashikon rastet e shkarkimit të anëtarit të KLD-së¹⁰.

6. Gjykata në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit

¹⁰ “Shkarkimi i anëtarit

Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ose nga Kuvendi në këto raste:

a) për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit;

b) për kryerjen e një krimi;

c) për paafësi mendore dhe fizike;

d) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;

d) vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e parashikuara në ligj.”



publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, ku në secilin prej tyre qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr.3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Kushtetuta, si akt themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren aktet normative, duke synuar qëndrueshmërinë e tyre. Kushtetuta, mbi bazën e të cilës miratohen të gjitha aktet e tjera normative, mund të ndërmerret si mision të saj edhe përcaktimin e përmbajtjes së ligjeve që duhet të miratohen në të ardhmen nga ligjvënësi. Kështu, konsiderohet si karakteristikë e kushtetutave të shkruara përcaktimi konkret i disa parimeve kryesore ose përjashtimi absolut i disa rrethanave që konsiderohen si të papranueshme për të (*shih vendimin nr.3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata është shprehur, gjithashtu, se rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithatë disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra,

Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por, Kushtetuta, përveç kësaj, mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht edhe rastet për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në këto parime, Gjykata ka theksuar se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira, me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë nuk është i nevojshëm referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se KLD-ja është një organ kushtetues i ngarkuar me funksionin për të emëruar e shkarkuar gjyqtarët si dhe me çështje të tjera që kanë të bëjnë me organizimin e sistemit të drejtësisë, sipas parashikimit kushtetues të nenit 147/4. Për këtë qëllim ai është konceptuar si organ i pavarur, cilësi kjo që karakterizohet nga mënyra e formimit të tij, me pjesëmarrjen e kreut të shtetit, të figurave më të larta të gjyqësorit (Kryetarit të Gjykatës së Lartë), përfaqësuesit të ekzekutivit (ministrit të Drejtësisë), përfaqësuesve të ligjvënësit (3 anëtarë), si dhe gjyqtarë të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Kjo përbërje jo vetëm synon pavarësinë e tij nga të gjitha pushtetet e tjera, por pasqyron edhe ndarjen dhe balancimin e pushteteve në KLD (*shih vendimin nr.14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).



12. Nga sa më lart, edhe pse sipas përcaktimeve kushtetuese mbajtja e dy funksioneve nuk është rregull, përjashtimisht neni 147/1 i Kushtetutës kushtëzon cilësinë e anëtarit të KLD-së me mbajtjen e një funksioni tjetër. Me fjalë të tjera, pikërisht për shkak të funksionit parësor (President i Republikës, Kryetar i Gjykatës së Lartë, ministër i Drejtësisë, funksionarë të lartë – përfaqësues i Kuvendit apo qenia gjyqtar) që ka një anëtar i KLD-së, bëhet e mundur pjesëmarrja e tij në KLD. Kjo edhe për faktin se ushtrimi i detyrës si anëtar i KLD-ës nuk kryhet me kohë të plotë.

13. Në këto kushte, kushtetutëbërësi nuk ka parashikuar rastet e shkarkimit të anëtarit të KLD-së, pasi për secilin prej anëtarëve të KLD-së Kushtetuta ka parashikuar, për funksionin parësor që ata kryejnë, mënyrën e shkarkimit të tyre nga detyra. Konkretisht, neni 90/2 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës; neni 140 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit nga detyra të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, pra edhe të kryetarit të saj; neni 147/6 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të nivelit të parë dhe të dytë. Ministri i Drejtësisë është funksionar politik, pjesë e ekzekutivit, dhe si i tillë lidhet me votëbesimin politik të shumicës qeverisëse. Pra, për anëtarët e KLD-së, ndryshe nga sa parashtron Kuvendi, duke qenë njëkohësisht mbajtës të funksioneve të tjera shtetërore, Kushtetuta ka parashikuar rastet e shkarkimit të tyre.

14. Nga parashikimet kushtetuese të lartpërmendura rezulton qartë se nëse secili prej anëtarëve të KLD-së ndodhet në një nga rastet e shkarkimit nga detyra për shkak të funksionit primar të tij, ai nuk mund të jetë më mbajtës i tij (President i Republikës, kryetar i Gjykatës së Lartë, gjyqtar, etj.) çka passjell se ai nuk mund të jetë detyrimisht as anëtar i KLD-së. Pra shkarkimi nga funksioni primar sjell për pasojë përfundimin e mandatit të tyre si anëtarë të KLD-së.

15. Për sa më lart, jam i mendimit se përderisa Kushtetuta, ndryshe nga sa ka parashikuar për institucionet e tjera kushtetuese, ka heshtur për përcaktimin e rasteve të shkarkimit nga detyra të anëtarëve të KLD-së, Kuvendi nuk legjitimohet që një gjë të tillë ta bëjë me ligj. Rregullimi

hipotetik, apo përjashtimor në këtë rast, ndonëse i sforcuar, mund të ishte i vlefshëm vetëm për sa u takon anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, të cilët nuk janë njëkohësisht (detyrimisht) mbajtës të funksioneve të tjera.

16. Në këtë kushte, mendoj se parashikimi me ligj i rasteve të shkarkimit të anëtarit të KLD-së deformon vullnetin e kushtetutëbërësit dhe si i tillë bie ndesh me nenet 4, 7, 116 dhe 147 të Kushtetutës.

17. Si përfundim, referuar edhe mendimit tim lidhur me kompetencën e Presidentit të Republikës për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së (*shih mendimin e pakicës së vendimit nr. 16, datë 10.014.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerësoj se Gjykata duhej të kishte shfuqizuar nenet 4 dhe 7 të ligjit nr.101, datë 31.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Mendoj se kjo çështje duhet të ishte pranuar vetëm pjesërisht për nenin 4/1, shkronja “a”, shprehja “për shkelje të ligjit”, si dhe për nenin 7 të ligjit nr. 101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, prandaj vlerësoj të shprehem me mendim pakice për të dyja problematikat e prekura nga këto dispozita ligjore në nivel kushtetues.

Për pretendimin se rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së cenojnë pavarësinë e gjyqësorit

2. Kërkuesi pretendon se neni 4 i ligjit, që parashikon rastet e shkarkimit nga detyra të anëtarëve të KLD-së cenon parimin e ndarjes së pushteteve dhe dobëson vetëqeverisjen e gjyqësorit. Ligji objekt kërkesë nuk bën dallime ose specifikime lidhur me rastet e shkeljes së rëndë të ligjit si shkak për shkarkimin e anëtarit të KLD-së duke lënë vend për abuzim dhe duke mosgarantuar ruajtjen e paprekshmërisë së këtij organi kushtetues.

3. Sipas nenit 4 të ligjit, “anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet përkatësisht nga **Konferenca Kombëtare Gjyqësore** ose nga Kuvendi në këto raste:



a) për shkëlqje të Kushtetutës dhe **të ligjit**;

b) për kryerjen e një krimi;

c) për paafësi mendore dhe fizike;

e) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;

d) kur vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e parashikuara në ligj.”

4. Ashtu sikundër evidenton dhe shumica, para këtij ndryshimi, në ligjin për KLD-në nuk kanë qenë të parashikuara rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD. Edhe Kushtetuta nuk ka të parashikuar ndonjë rast shkarkimi të tyre, por vetëm zgjedhjen dhe kohën e qëndrimit në detyrë. Duke iu referuar materialit të paraqitur në Komisionin e Ligjeve nga nismëtarët e projektligjit si dhe raportit të Komisionit të Ligjeve drejtuar Kuvendit, (seancës plenare) rezulton se qëllimi i këtij parashikimi ka qenë plotësimi i boshllëkut ligjor që ka ekzistuar deri sot, pasi KLD-ja është i vetmi organ kushtetues për të cilin nuk janë parashikuar raste të shkarkimit ose/dhe përfundimit para kohe të mandatit.

5. Sipas shumicës, shkaqet e parashikuara në nenin 4 të ligjit për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk janë të qarta dhe nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tyre. Në këto kushte, kjo dispozitë nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, përse i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje, dhe si e tillë është antikushtetuese dhe duhet shfuqizuar. (*prg.33 i vendimit*).

6. Gjykata Kushtetuese ka elaboruar jo vetëm pavarësinë, por edhe llogaridhënien në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Sipas saj, ky parim, duke mos qenë qëllim në vetvete, ndihmon që pushteti të shpërndahet në disa mbajtës me funksione e detyra të ndryshme, për të siguruar reciprokisht një drejtësi më të madhe në ushtrimin e tij. Nga ana tjetër, ky parim ndihmon, gjithashtu, edhe në bashkëveprimin e mbajtësve të pushteteve, duke siguruar shkallë garancie dhe siguri më të lartë në marrjen e vendimeve të drejta dhe të peshuara. Ky parim u kërkon organeve jo vetëm të respektojnë njëri-tjetrin në ushtrimin e funksioneve të tyre, por edhe të kontrollohen e ndihmohen në mënyrë të ndërsjella me qëllim funksionimin sa më mirë të

sistemit të qeverisjes. (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 19, datë 03.05.2007*).

7. Nisur nga këto premisa, mendoj se kontrolli ndaj vetëqeverisjes së gjyqësorit brenda parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nëpërmjet mekanizmave kushtetutës, është vlerë kushtetuese në funksion të dhënies së drejtësisë. Nga ana tjetër, edhe llogaridhënia si standard kushtetues për funksionarë të organeve kushtetuese, ka një element të rëndësishëm të saj edhe shkarkimin nga detyra, në rastet e parashikuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt, KLD si strukturë e vetëqeverisjes së gjyqësorit nuk mund të mos jetë pjesë e llogaridhënies institucionale apo personale të anëtarëve të saj.

8. KLD-ja përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi si dhe 9 anëtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore. Neni 147/6 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit. Neni 90/2 i Kushtetutës parashikon rastet e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Neni 140 i Kushtetutës përcakton rastet e shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, rregullim që vlen edhe për Kryetarin e Gjykatës së Lartë, si anëtar *ex officio* i KLD-së. Duke qenë se për anëtarët e përmendur më lart Kushtetuta ka përcaktuar rastet e shkarkimit sipas dispozitave përkatëse, shkarkimi i tyre nga funksioni primar do të sillte edhe shkarkimin si anëtar i KLD-së.

9. Bazuar mbi këto konsiderata, duke qenë se 9 gjyqtarët, si anëtarë të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore, këtë mandat e kanë nga pozicioni i tyre si gjyqtarë, i gjykoj të panevojshme specifikimet ligjore të shkarkimit të tyre, sikundër ka përcaktuar neni 4 i ligjit objekt kundërshtimi. Në të kundërt, specifikimet në lidhje me rastet e shkarkimit të anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi si anëtarë KLD-je, i gjykoj si të domosdoshme. Kjo, sepse të vetmit anëtarë për të cilët dispozitat kushtetuese dhe ligjore nuk kanë parashikuar rastet e shkarkimit janë 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, prandaj në këtë prizëm rregullimi ligjor për këtë kategori funksionari të rëndësishëm kushtetues ligji mbulon një boshllëk që Kushtetutëbërësi nuk e ka parashikuar.



10. Anëtarët e KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi mund të jenë funksionarë që mbajnë detyra të tjera publike, por mund të jenë edhe funksionarë që punojnë ose jo me kohë të plotë dhe që mund të ushtrojnë profesionin edhe në sektorin privat. Në këto kushte, përcaktimi me ligj i rasteve të shkarkimit të tyre nga detyra është brenda detyrimit për kontroll të veprimtarisë së tyre nga organi emërues si anëtarë të KLD-së dhe mbajtjes përgjegjësi për këtë detyrë, ndryshe nga anëtarët e tjerë që janë anëtarë për shkak të një funksioni tjetër parësor (Presidenti i Republikës, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë dhe 9 gjyqtarët).

11. Për sa më sipër, mendoj se në nenin 4 duhej shfuqizuar vetëm pjesa që përcaktonte rastet e shkarkimit të anëtarëve të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore, të shprehjes *“përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ose”*, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të dispozitës për anëtarët e KLD-së që zgjidhen nga Kuvendi, si rregullim ligjor i domosdoshëm në aspekt të parimeve kushtetuese të llogaridhënies dhe mbajtjes përgjegjësi në ushtrimin e funksioneve kushtetuese.

12. Gjithashtu, po në këtë dispozitë, rasti i parë i parashikuar si arsye shkarkimi, shkronja “a”, fraza “për shkelje të ligjit”, për mendimin tim krijon paqartësi në kuadër të sigurisë juridike, me të njëjtin argument të dhënë nga shumica, prandaj edhe kjo frazë duhej shfuqizuar. Mënyra e formulimit në ligj e këtij shkak për shkarkim, duket sikur e lë të hapur dhe të diskutueshme bërjen e interpretimeve pa fund të rasteve potenciale që mund të klasifikohen nga organi shkarkues Kuvendi si shkelje e ligjit.

Për pretendimin se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi bie ndesh me nenin 147 të Kushtetutës

13. Kërkuesi pretendon se neni 7 i ligjit objekt kërkese, që parashikon zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, është interpretim i ngushtë i nenit 147/3 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë bie ndesh me të. Kushtetuta është mjaftuar vetëm me parashikimin që ai të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KLD-së, pa bërë dallime midis mënyrës së zgjedhjes së tyre. Sipas kërkuesit, kjo gjë është në tejkallim të parashikimit kushtetues.

14. Sipas nenit 4/3 të Kushtetutës, *dispozitat e*

Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky është një parim themelor, sipas të cilit kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përrjashtimi kushtetues nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

15. Në zbrëthim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kushtetuta, kur e ka parë të arsyeshme, ka parashikuar shprehimisht zbatimin e drejtpërdrejt të saj ose nuk ka lënë hapësirë rregulluese për ligjvënësin. Si rrjedhim, përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira, me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë nuk është i nevojshëm zbatimi i drejtpërdrejt i saj. Nëse ndodhemi para kësaj situatë, është e pritshme që aktet normative, që do të dalin për këtë qëllim, të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*vendimet nr. 29/2005 dhe nr.3/2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas kësaj gjykate, për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. (*vendimi nr. 212/2002*).

16. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Neni 147/3 i Kushtetutës parashikon se *KLD-ja me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar.* Kjo dispozitë është e qartë, koncize dhe mjaftueshmërisht vetërregulluese për t'u zbatuar edhe në mungesë të një ligji detajues. Por duke qenë se ndodhemi para rastit kur ligjvënësi ka vlerësuar të nevojshëm rregullimin me ligj, kjo ndërhyrje do të duhej të ishte e tillë që të mos kufizonte rrethin e subjekteve të propozuara nga Presidenti si kandidatë për zëvendëskryetar të KLD-së, në mungesë të autorizimit të shprehur kushtetues për këtë veprim.



17. Në këtë këndvështrim, në rastin konkret, ndryshimi që ka sjellë neni 7 i ligjit objekt kërkese, sipas të cilit Presidenti për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së duhet të kufizohet mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, pra tek 3 anëtarë, ndryshon modelin kushtetues përzgjedhës. Mendoj se ky rregullim ligjor nuk është në pajtim me vullnetin e kushtetutëbërësit, i cili nuk ka parashikuar asnjë kufizim për këtë rast, prandaj dhe Presidenti nuk do të duhej të kufizohej në përzgjedhjen e zëvendës Kryetarit.

Kryetar: Bashkim Dedja

VENDIM
Nr. 24, datë 27.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 05.02.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 70/37 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Kleoniqi Sovjani

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Financave Zyra Përmbartimore “Albius”, Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 5021, datë 02.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 6, 13 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me kontratën e datës 14.11.1995, kërkuesja Kleoniqi Sovjani ka blerë nga Uzina e Instrumenteve Korçë objektin Reparti i Tërheqjes së Ftohtë dhe truallin nën të. Kjo kontratë është kundërshtuar në gjykatë nga trashëgimtarët e ish-pronarit të kësaj sipërfaqeje trualli, të cilëve, me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Korçë, u ishte njohur e drejta e parablerjes së objektit të ndërtuar mbi të.

2. Me vendimin nr. 339, datë 21.02.1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është ndryshuar me vendimin nr. 183, datë 04.11.1998 të Gjykatës së Apelit Korçë, i cili ka vendosur pranimin e padisë dhe pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes të datës 04.11.1995, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Me vendimin nr. 782, datë 20.07.1999, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 183, datë 04.11.1998 të Gjykatës së Apelit Korçë.

3. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, Zyra e Përmbartimit Korçë, me shkresën e datës 23.05.2001, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Privatizimit për kryerjen e veprimeve për kthimin e shumave të paguara nga kërkuesja dhe konkretisht të shumës prej 5.638.320 lekësh si vlerë e truallit dhe të shumës prej 9.118.000 lekësh si vlerë e ndërtesës.

4. Për shkak të mosekzekutimit të detyrimit, kërkuesja i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës me objekt detyrimin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike për kthimin e shumës prej 23.023.320 lekësh. Me vendimin nr. 5021, datë 02.06.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadiës së paditëses Kleoniqi Sovjani. Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike t’i kthejë palës paditëse Kleoniqi Sovjani shumën prej 870.000 (tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh si dhe shumën prej 5.638.320 (pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet) lekësh në letra me vlerë privatizimi, 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë në bono privatizimi dhe 13.015.000 (trembëdhjetë milionë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë në bono privatizimi...”*



5. Me vendimin e datës 16.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin nr. 5021, datë 02.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kërkesja i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Me shkresën nr. 231/1 prot., datë 25.02.2009, ky institucion i është përgjigjur kërkujeses se vendimi i formës së prerë është ekzekutuar duke kthyer shumën prej 870.000 lekësh së bashku me shpenzimet gjyqësore. Për sa i përket vlerës së paguar në bono privatizimi, nga shkresa rezulton se *“në zbatim të VKM-së nr. 1636, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” dhe udhëzimit nr. 385, datë 16.12.2009 të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë të Financave “Për zbatimin e VKM-së nr. 1636, datë 17.12.2008 ...” do të kethehen pasi të jenë grumbulluar në vlerat përkatëse në bono privatizimi nga procesi i privatizimit pranë numrave të llogarisë së Ministrisë së Financave pasi ky institucion nuk disponon bono privatizimi.”*

7. Me kërkesën e datës 25.10.2013, kërkesja i është drejtuar shërbimit përmbarimor privat për fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Me shkresën nr. 580, datë 25.10.2013, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar debitorit, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, me lajmërim për ekzekutimin vullnetar. Me vendimin nr. 618, datë 12.11.2013, përmbaruesi gjyqësor ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimit, kurse me shkresën nr. 649, datë 06.12.2013 është kërkuar informacion lidhur me gjendjen financiare të debitorit pranë Bankës së Shqipërisë.

8. Me shkresën nr. 18969/1 prot., datë 30.12.2013, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave i ka kthyer përgjigje përmbaruesit se në lidhje me ekzekutimin e asaj pjesës së detyrimit në letra me vlerë privatizimi dhe bono privatizimi nuk ka ende një vendimmarrje.

9. Me shkresën nr. 4 prot., datë 10.01.2014, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar Ministrisë

së Financave për ekzekutimin e detyrimit. Me shkresën nr. 18969/3 prot., datë 03.03.2014, Ministria e Financave i ka kërkuar përmbaruesit gjyqësor vënien në dispozicion të një kopjeje të konfirmuar të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Me shkresën nr. 54 prot., datë 04.03.2014, përmbaruesi gjyqësor i ka dërguar Ministrisë së Financave aktet e kërkuara.

10. Me shkresën nr. 73 prot., datë 21.03.2014, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar Ministrisë së Financave (Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit) me paralajmërim për aplikimin e sanksioneve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile (KPC) për pengimin e ekzekutimit.

11. Me shkresën nr. 117 prot., datë 24.04.2014, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar Ministrisë së Financave për dhënien e informacionit mbi gjendjen e llogarisë të artikullit buxhetor 602 dhe fondin në letra me vlerë privatizimi dhe në bono privatizimi të Ministrisë së Financave.

12. Me shkresën nr. 124 prot., datë 02.05.2014, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar sërish Ministrisë së Financave me paralajmërim për aplikimin e sanksioneve ligjore për mosekzekutimin e detyrimit. Me shkresën nr. 18969/6 prot., datë 16.05.2014, Ministria e Financave i është përgjigjur përmbaruesit gjyqësor: *“Aktualisht procesi i privatizimit të pronës publike shtetërore është ndërprerë, pasi Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike nuk ka tagër ligjor për realizimin e procedurave të privatizimit, gjë e cila do të bëhet e mundur pas miratimit të akteve të reja ligjore. Për sa më sipër, deri në krijimin e fondit përkatës bono privatizimi dhe letra me vlerë nga privatizimi i pronës publike shtetërore, nuk mund të realizohet kthimi i shumës së kërkuar nga ana juaj”*.

13. Me shkresën nr. 6822/1 prot., datë 20.05.2014, Ministri i Financave i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për ta informuar lidhur me problematikën për çështjen e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të dhënë në favor të kërkujeses. Ky institucion ka shprehur vullnetin për ekzekutimin e pjesës së pashlyer të detyrimit, çka bëhet e pamundur për shkak të mungesës së bazës ligjore ku të mbështetet e drejta e Ministrisë së Financave për të blerë në tregun e lirë sasinë e mjaftueshme të letrave me vlerë privatizimi dhe bono privatizimi, mungesës së



një kurs zyrtar këmbimi të letrave me vlerë të privatizimit, si dhe ndërprerjes së privatizimit të pronës publike shtetërore. Po ashtu në shkresë i kërkohet Ministrit të Drejtësisë marrja e masave përkatëse.

II

14. **Kërkuesja Kleoniqi Sovjani**, nëpërmjet përfaqësueses të saj (sipas prokurës së posaçme bashkëlidhur kërkesës), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, dhe parashtron këto shkaqe:

14.1 Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë është element thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt. Mosekzekutimi i detyrimit nga pala debitore ka shkelur të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor, pasi vite të tëra nuk mund të konsiderohen si kohë e arsyeshme pritjeje për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

14.2 Në rastin konkret ekziston një vendim i formës së prerë, i cili shprehet qartë për detyrimin që ka pala debitore ndaj kërkueses. Megjithëse kërkuesja u zhvesh në mënyrë të menjëhershme nga e drejta e pronësisë, pala debitore ende nuk e ka ekzekutuar detyrimin e saj.

14.3 Vendimet e gjykatave nuk do të kishin asnjë vlerë dhe nuk do të mund të riparoheshin asnjë padrejtësi në qoftë se nuk do të ekzekutoheshin. Moszbatimi i tyre nuk sjell gjë tjetër veçse kaos dhe humbje të besimit në sistemin ligjor dhe në ligj.

15. **Subjekti i interesuar Ministria e Financave** ka parashtruar me shkrim para Gjykatës sa vijon:

15.1 Ministria e Financave nuk e ka kundërshtuar ekzistencën e detyrimit dhe ka filluar ekzekutimin e pjesëshëm të tij konform dispozitave ligjore në fuqi. Konkretisht, me urdhër shpenzimit nr. 893, datë 30.12.2008 në llogarinë e kërkueses është transferuar nga Ministria e Financave shuma prej 1.106.933 lekësh, që përbën shumën prej 870.000 lekësh, pra pjesën e detyrimit në lekë, dhe janë paguar shpenzimet gjyqësore sipas vendimit të gjykatës.

15.2 Nga ana e Ministrisë së Financave nuk është shfaqur asnjëherë vullneti për të mos ekzekutuar apo penguar ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Pjesa e mbetur e detyrimit, e

llogaritur në bono privatizimi dhe letra me vlerë, nuk është ekzekutuar për shkak se: ka munguar baza ligjore për të blerë në tregun e lirë sasinë e mjaftueshme të letrave me vlerë privatizimi dhe bonove të privatizimit; ka munguar kurs zyrtar i këmbimit midis bonove të privatizimit/letrave me vlerë dhe monedhës lek.

15.3 Neni 527 i Kodit Civil parashikon se kur pamundësia për ekzekutimin e një detyrimi është e përkohshme, debitori nuk është përgjegjës për vonesën e ekzekutimit apo për kohën që ekzekutimi zgjat.

15.4 Edhe pse në rastin konkret fondet buxhetore nuk mungojnë, pasi objekti në fjalë së bashku me truallin janë shitur sërish në ankand me vlerë më të madhe, mungesa e një baze ligjore të përshtatshme ka kushtëzuar ndjeshëm mundësinë e Ministrisë së Financave për të kryer ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

16. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 9, datë 14.02.2014 dhe nr. 24, datë 22.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.



18. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Në jurisprudencën konstante të Gjykatës, mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 21, datë 03.06.2011 dhe nr. 9, datë 14.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për rrjedhojë, për të arritur në një konkluzion nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i) Kompleksiteti i çështjes

20. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkrësore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2010 dhe nr. 9, datë 14.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit të vlerës në bono privatizimi dhe letra me vlerë. Megjithatë, mungesa e fondit përkatës në bono privatizimi dhe letra me vlerë, si edhe mungesa e një baze ligjore për përcaktimin e vlerës së tregut dhe kursit të këmbimit për konvertimin e tyre në lekë është një çështje që ka ndikuar në kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimit.

ii) Interesi dhe sjellja e kërkuarës

22. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Gjykata ka

theksuar se përdorimi nga ana e kërkuarit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 14, datë 15.04.2010 dhe nr. 24, datë 22.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret interesi i kërkuarës është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e saj të pronësisë. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuarja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të saj për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ajo ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iii) Sjellja e autoriteteve

24. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 04.03.2010 dhe nr. 24, datë 22.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen në shqyrtim rezulton se përmbaruesi gjyqësor, në cilësinë e subjektit procedural në fushën e ekzekutimit, ka kryer të gjitha veprimet procedurale për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ai jo vetëm i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por ka vendosur edhe masën me gjobë ndaj eprorit të institucionit debitor. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ky subjekt jo vetëm që nuk është bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, por ai ka vepruar në përputhjet me kompetencat e tij ligjore.

26. Në lidhje me sjelljen e debitorit, Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt



mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit të vlerës në letra me vlerë dhe bono privatizimi. Në komunikimet me kreditorin, Ministria e Financave ka pretenduar se procesi i privatizimit është ndërprerë, çka ka çuar në mungesën e fondit përkatës në bono privatizimi dhe letra me vlerë, kurse në parashtrimet para Gjykatës ajo ka pretenduar mungesën e bazës ligjore për të blerë në tregun e lirë sasinë e mjaftueshme të letrave me vlerë privatizimi dhe bonove të privatizimit, si dhe mungesën e një kursi zyrtar këmbimi, çka ka ndikuar në kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimit.

27. Sipas ligjit nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi) dhe dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit”, i ndryshuar, afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2014 (neni 3). Sipas nenit 7 të ligjit “*Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e emetimit dhe të shpërndarjes së bonove, rregullat e përdorimit në procesin e privatizimit, si dhe rregullat e tjera të nevojshme në zbatim të këtij dekreti.*” Sipas nenit 11 të ligjit “*Ministria e Financave ngarkohet me përgatitjen e dispozitave ligjore për organizimin dhe veprimtarinë e shoqërive investuese të letrave me vlerë dhe për veprimtarinë e bursës.*”.

28. Gjykata vlerëson se, pavarësisht ndikimit që ka pasur mungesa e bazës ligjore apo e një fondi në bono privatizimi dhe letra me vlerë në kohëzgjatjen e ekzekutimit, nga ana e debitorit nuk rezulton që të jetë bërë asnjë përpjekje për rregullimin e kësaj situatë. Edhe pse debitori e ka njohur detyrimin dhe ka shprehur vullnetin për ekzekutimin e tij, ai nuk ka marrë masa të mëtijshme për të bërë të mundur ekzekutimin e këtij detyrimi. Gjykata është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 2, datë 01.02.2011 dhe nr. 10, datë 01.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë nga argumentet e paraqitura para Gjykatës nga debitori nuk është i tillë që të justifikojë mosveprimin e tij për gjetjen e mjetit ligjor më të përshtatshëm për ekzekutimin e

detyrimin, edhe pse ka kaluar një periudhë kohe e cila nuk mund të konsiderohet si e arsyeshme.

29. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5021, datë 02.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja, (kryetar) Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 259 lekë